



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXIV / Nr. 03 / Mars 2025



Agjërimi
që kërkohet



“DRITA ISLAME”

Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsk.al

Viti XXXIV i botimit

Nr. 03 (502)


Mars, 2025

ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al





editorial

04 Ata që do të vijnë në kohëra më të mira
Mehmet Disha

në fokus

06 Agjërimi që kërkohet
Dorian Demetja

lajme / aktivitete

08 **01-KMSH vlerëson ambasadorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite, sh.t.z. Faisal Ghazi Hifzi**
02-Këshilltari i drejtorit të përgjithshëm të "Rahma Global Society" viziton KMSH-në
03-Mbledhje pune administratorët e qarqeve
04-KS Relief dhuron 25 ton hurma arabe për besimtarët
05-Zhvillohet aktiviteti i përbashkët sportiv "Kupa e Ramazanit"
06-Programi artistik kushtuar vlerave të muajit të bekuar të Ramazanit

refleksione

14 Kur adetet bëhen ibadete
Mustafa Gündodu

çështje fetare

18 Muaji i madhërisëm i Ramazanit përmes pyetjeve II
Këshilli i çështjeve fetare - insi.al

familja

20 Parimet e Edukimit Profetik: "Duaj dhe trego mëshiro"
Armand Asllani

horizonti i besimit

22 Çështje rreth agjërit të gruas në Ramazan
Fatma Karaj

24 Nata e Kadrit - ftesë e shpirtit për në lartësim
Leonard Çela

26 Zekati dhe disa rregulla të tij
Resul ef. Rexhepi

jetë sahabësh

28 Profesioni i Sahabeve dhe veçoritë e tyre
Tauland Bica

bota shpirtërore

30 Trupi dhe shpirti
H. Ismail Muçej

shëndet

32 Mësimet morale dhe parandalimi i kancerit
M. A. Al-Ahari

hapësirë feminare

36 Drita mahnitëse
Orhan Sezgin

këndi i poezisë

38 Pjesë nga divani i Imam Shafiut
Imam Shafi



Ata që do të vijnë në kohëra më të mira



Pothuajse në të gjitha epokat që kanë kaluar, e vërteta rrallëherë ka qenë e lehtë për t'u mbajtur dhe për t'u bartur për tek të tjerët. Ka patur gjithnjë kohë kur vështirësia për t'u kapur pas të vërtetës dhe për të mbajtur e siguruar jetën me të, qe pikërisht kërcënim për vetë jetën dhe jetesën e njerëzve. Përcjellja e mesazhit hyjnor nuk qe e lehtë për asnjë nga profetët dhe pasuesit e tyre. Pati prej tyre që u vranë, u luftuan, u përçmuan, u ndoqën, u torturuan, u lanë të vetmuar mënjanë, u syrgjynosën, u ndoqën këmba-këmbës, u sharruan më dysh, vuajtën periudha skamjeje e urish lodhëse. Kësisoj, të përballur me këto llahtari, shpirtrat e etur për mbijetesë, pa lënë mangët qëndrueshmërinë e durimin, shtrënguan dhëmbët në mënyrë trimërore dhe ruajtën zemrat nga korrupsioni, gjuhët nga ndryshkja, shpirtrat nga tjetërsimi dhe botëkuptimet e tyre nga zvenitja në ujrat e prishur të shoqërive në kohëra të ndryshme.

Ata që pasuan të dërguarit e Zotit me sinqeritet e drejtësi, çuan përpara dituritë që i morën si amanet dhe trashëgimi prej profetëve, ajkën e mëshirës së Zoti që pikoi prej zemrave profetike për tek zemrat e njerëzve të mirë, pikërisht ato dituri me të cilat njerëzimi do të mëkonte plagët e injorancës

dhe rrënimit shoqëror për shekuj me radhë.

Mundimet dhe vështirësitë që patën besimtarët e parë që iu bashkuan Profetit Muhamed (a.s.) qenë tepër të vështira. Po ashtu, teksa rrethi i besimtarëve që i bashkoheshin safit të Islamit zgjerohej, vështirësitë vazhduan edhe tek ata. Kur'ani tërheq vërejtjen e besimtarëve duke zgjeruar dimensionet e zemrave të tyre rreth kësaj rruge: 'A vërtetë i bëtë llogaritë e menduat se do të hyni në Xhenet, pa u sprovuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush, të cilëve u ra skamja e vuajtjet dhe qenë tronditur, saqë i Dërguari, bashkë me ata që kishin besuar me të, thoshin: "Kur do të vijë ndihma e Allahut"?! Po a nuk është ndihma e Allahut afër?!" Po, popujt e të vërtetës qenë ballafaquar me tortura gjer në vdekje, rrahje dhe prangosje, përndjekje dhe kërcënime që të linin rrugën e profetit dhe të mos e ndiqnin atë. Nuk u dorëzuan. Shpërblimet e Allahut për ta janë të paimagjinueshme, karshi kësaj jete të përkohshme e munduese atyre u jepet përjetësia e Xheneti.

Po ashtu, uria qe bashkëshoqëruese e të Dërguarit të Zotit i cili shpeshherë agjëronte në vazhdim pa bërë iftar. Teksa bëheshin punimet e gërmimet për t'u përgatitur për luftën

e Hendekut, sahabët i thoshin Profetit se kishin lidhur nga një gur në barqet e tyre për të zëtekur urinë. I dërguari i Zotit u tregonte se ai vetë kishte lidhur jo një, po dy gurë për të njëjtën gjë. Kështu ka qenë rrugëtimi i të vërtetës së Kur'anit dhe të imanit që të mbërrinte gjer tek ne. Ebu Hurejre r.a. na tregon se një ditë e pa të Dërguarin e Allahut a.s. teksa po falej ulur dhe, i shqetësuar, e pyet si është puna. I dërguari i Allahut i thotë: "O Ebu Hurejre, e kam nga uria." dhe Ebu Hurejres zunë t'i rridhnin lotët rrëke. Atëherë, i dërguari i Allahut a.s. i thotë: "Mos qaj, o Ebu Hurejre. Vështirësitë e ditës së Kiametit nuk e zënë atë që në këtë botë vuan nga uria dhe e di që e ka shpërblimin te Zoti."

Duhet të jemi në dijeni se shembulli i jetës së Profetit Muhamed a.s. është jashtëzakonisht i mbushur me vështirësi të cilat, u kaluan me sukses falë durimit, shpresës, guximit, mposhtjes së frikës, teuekkulit (mbështetjes te Zoti) besimit dhe përpjekjes së palodhur, si në vitet e vështira të Mekës, si në Medine, si në luftën e Bedrit, apo atë të Uhudit, e në përlëshjet e tjera, si edhe po njësoj në shekujt që pasuan, pati prej atyre trimave e trimëshave që sakrifkuan jetët, e jo vetëm, shkuan më më tej, teksa jetonin, sakrifkuan jetesën; teksa qeshnin mbajtën fshehur dhimbjet dhe morën nga një plagë për secilën qeshje. Jetuan të lirë e të pakorruptuar edhe kur u gjendën të ndryrë në burgjet e të padrejtëve; lanë mangët çapën e bukës, ose, dhe kur e patën një çapë, e hëngrën atë thatë, si Hafiz Sabriu ynë i mirë, me një kokërr qepë në xhep, agjëronte nga iftari në iftar, me atë copë hallall ndriçonte ditët, netët, si e si të mos shiste shpirtin për pesë parë dynja, si e si për të bërë të mundur që Islami, së pari, brenda tij të mos binte, që morali të mos trettej, që besimi të mos ndotej me dyshime, si dhe e vërteta të mos humbej duke vërtetuar kuptimin rrënjësor të kësaj feje të bukur të stolitur me ideale të larta, që është: dorëzimi tek Zoti.

Gjithë kjo sakrificë për të ruajtur thëngjijtë të mos shuheshin e të përçoheshin për tek brezat e tjerë. Gjithë kjo përpjekje për të ruajtur flakën e dashurisë për Zotin dhe të Dërguarin e Tij (s.a.s.). Farëra të sinqerta që buruan prej zemre, që u bartën në ujrata e kohërave, që të mund të zinin vend në fusha, në brigje, diku në një cep atje, gjersa të gjenin kohën e përshtatshme kur kaderi hyjnor do u jpte urdhrin për të mbirë e për të hedhur shtat.

Për ata shpirtra të pastër e të dëlirë, feja qe buka e përditshme e qenies; për ta e vërteta qe si oksigjeni, si fryma, si ajri... Në llogoret e mundimeve e të vështirësive, shndriste balli i atyre që rendën pas të vërtetës të përzhitur nga malli për të fituar kënaqësinë e Zotit, e që më pas udhëtuan për në amshim dhe si gjithë të tjerët, zunë varret dhe ranë në prehje. Më pas, Zoti i lartësoi duke ngritur si përmendore në ndërgjegjet e të mëvonshmëve, amanetin e tyre.

Allahu i Lartësuar në disa ajete kuranore na tërheq vëmendjen drejt unifikimit me të parët në rrugën e drejtë dhe jo në ato sisteme që i sollën njerëzit e prishur. Ky unifikim pasqyron vlerën e historisë dhe sakrificën e njerëzve të përzgjedhur të Zotit. Po kështu edhe profeti Muhamed a.s.

erdhi në gjurmët e profetëve dhe ftoi për tek Zoti dhe feja e Zotit, duke ndrequr kështu edhe ato tablo dhe përcjellje të gjymtuara të historisë, ku Isai a.s., Musai a.s., Ibrahim a.s., Jakubi a.s., Ishaku a.s. dhe të gjithë profetët i kanë ftuar njerëzit tek e njëjta rrugë dhe jo në ndasi apo në politeizëm, por në njëshmërinë e Zotit dhe në unitetin e bashkësisë së njerëzve që ndjekin udhën e Tij, si ummet. "Luftoni në rrugën e Allahut, ashtu si duhet luftuar. Ai ju ka zgjedhur dhe nuk ju ka vënë asnjë barrë në fenë tuaj, fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai ju ka quajtur ju myslimanë qysh më parë (në Shkrimet e Shenjta) dhe në këtë (Kuran), me qëllim që i Dërguari të jetë dëshmitar mbi ju dhe që ju të jeni dëshmitarë mbi njerëzit e tjerë. Andaj, faleni namazin, jepni zekatin dhe mbështetuni tek Allahu! Ai është Mbrotjtësi juaj. Sa Mbrotjtë dhe Ndhimës i mrekullueshëm është Ai!"

Ne erdhëm në kohëra më të qeta. Asokohe rruga e të parëve qe plot ferra, qe dimër e borë, rrugët qenë të zëna, a në mos me thepisje, dhe ideja e ditëve më të mira për ta qe thjesht një ëndërr; mirëpo, ata u kapën pas kësaj ëndrre dhe me të mbajtën gjallë fillin e shpresës. Brezat që vijnë në prag të pranverës, së pari, duhet të qëndrojnë në parvazin e të vjetërve dhe t'u çojnë selame, bekime, lutje e mirënjohje për mirësinë e sakrificën që bënë. Falë përpjekjeve të tyre të sinqerta dhe përgjërimeve të tyre të zellshme, Zoti nuk e shuajti besimin e brezave.

Ne gjetëm gjurmë lehtësimi në prag të çdo horizonti që shkelëm. Gjetëm thëngjij të pashuar. Gjetëm dritë të pashuar. Gjetëm aty pak ujë, bukë dhe kripë të lëna nga dashuria dhe zelli i njerëzve të Zotit, se mbase bijtë e bijat me vonë do mbërrinin aty të lodhur, të sflitur e të tretur nga etja dhe uria. Ne qëndrojmë në shqem të këtyre horizonteve të jashtëzakonshme e teksa flladi i pranverës na rreh ëmbël ballin, themi të përmalluar, me plot mirënjohje; "Selam atyre që na deshën pa na parë! Selam atyre që sakrifkuan dhe nuk u dorëzuan! Zoti qoftë i kënaqur me ta dhe me ne bashkë!"

Amanetet kërkojnë qëndrueshmëri dhe supe të forta. Njerëzit që do të çojnë përpara karvanin e besimit në dyert e të tjerëve që do të vijnë më vonë, do të përballen sërish me të njëjtat sprova e vështirësi, krahas lehtësimeve që bota materiale ofron në të tashmen.

Ndofta diku në një cep tjetër të botës mbase ka ende njerëz që, për shkak të besimit të tyre dhe përpjekjes për të ecur në rrugën profetike, janë të burgosur, të persekutuar, luftohen, mbi ta bien padrejtësitë si shirat, mbi ta lëshohen kershëri plumbat dhe bombat, mbi ta fle uria e skamja. E ka të tjerë që e kanë më të lehtë jetën, po në të njëjtin glob. Zemrat tona duhet të jenë të zgjuara, të gjalla mjaftueshëm për të ndërjer dhimbjen e çdo njeriu në tërë rruzullin tokësor dhe lipset që lutjet për ta të jenë të pandërprera.

Pa ngecur tek rehatia dhe kënaqësia e nefseve, horizontet e zemrës e të shpirtit thërrasin për trimërinë e kohës, për të fituar kënaqësinë e Zotit duk u unifikuar me njerëzit e sinqertë të Zotit.



Agjërimi që kërkohet

Njeriu gjendet pranë Zotit të tij, për aq sa është larg nefsit së tij. Ose e thënë ndryshe: Njeriu duhet të jetë sa më larg unit të tij dhe egos së tij, që të jetë më pranë Zotit. Sot, në shumë raste shikojmë që agjërimit i ngeli vetëm forma. Namazi ngeli i përbërë veç prej disa formaliteteve ulje-ngritjesh. Sikur feja jonë të ishte një Islam folklorik. Domethënë realizimi vetëm i disa formaliteteve të caktuara. Si kanë qenë sahabët? Po ashtu, si qenë tabiinët, që vinin menjëherë pas tyre? E ndoshta

në një shkallë të tretë, si qenë tebe-i tabiinët, që vinin pas tyre? Po gjithë njerëzit e mendimit që përfaqësonin periudhat e tjera, shekujt e ndryshëm, apo reformuesit e mendimit, si qenë ata? Duhet t'i kërkojmë, ato ç'kemi humbur pikërisht në mënyrën e tyre të jetesës dhe në stilin e tyre të veprimit. Pastaj të themi: Ah, edhe këtë e paskemi humbur! Paskemi humbur pasionin, paskemi humbur dëshirën, paskemi humbur emocionet. Duhet t'i drejtohemi dhe njëherë vetes, e duke u

përballur me të, ta pyesim se a jemi duke e jetuar atë Islam po në atë shkallë, siç përfaqësohej prej Profetit tonë (a.s.), apo ashtu siç ai pasqyrohej tek të tjerët përreth tij? Parë në këtë këndvështrim, muaji i Ramazanit është si një hap i mundshëm për t'u hedhur në rrugëtimin drejt atij Islami.

Agjërimin e mbajnë dy kategori njerëzish. E para është agjërimi i njerëzve të thjeshtë, i cili përkufizohet vetëm me stomakun. Të hash një vakt bukë në syfy, e pastaj të bësh edhe një iftar në mbrëmje. Ky është agjërimi i njerëzve të rëndomtë. Nëse njeriu nuk e mban dot gojën prej shpifjes, prej përgojimit, fyerjeve, gënjeshtreve, sharjes së këtij apo atij personi, apo prej vetëmburrjes, duke mos i vënë dot frerë vetes, do të thotë që po e mban thjesht agjërimin e njerëzve të rëndomtë e të thjeshtë. Ky quhet thjesht agjërim si formë. Agjërim si dukje. Agjërim i lidhur pas imitimit. Po edhe kaq, a e pranon vallë Allahu (xh.sh.)?

E dyta është agjërimi i të veçantëve, i cili përbëhet nga detyrimi i të gjitha organeve dhe të gjithë përbërësve, fizikë apo metafizikë që të agjërojnë. I dorës, syrit, gojës, veshit, këmbëve, gjuhës...T'i bësh të agjërojnë këmbë e dorë, syrin e veshin, gjuhën e buzët, si dhe mendimet. T'i fusësh në agjërim madje edhe ato ç'mund të të shkojnë nëpër mend. Ti kushtosh kujdes edhe imagjinatës. Ta zëmë se në një cep të imagjinatës ju shkoi ndërmend ofendimi i dikujt. Pyetja e bërë vetes: A mos, m'u prish shpirti i agjërimit?! Nuk e ruajta dot parimin tim. Nuk e ruajta nderin dhe krenarinë e agjërimit tim në mendim dhe imagjinatë. Pra, të mos hash e të mos pish, por krahas saj të përpiqesh të qëndrosh i pastër prej fjalëve, mendimeve apo imagjinatave të ndotura. Të përpiqesh t'i mbash sa më të kulluara e të paprekura. Dhe ky është agjërimi i të veçantëve. Pikërisht ky horizont do rrekur për t'u kapur, duke e ngritur sa më shumë nivelin e pritshmërive.

Besimtari që është në kërkim të devotshmërisë, duhet të përpiqet ta kalojë jetën e tij me parimin: A nuk ka edhe më? A nuk ka edhe më thellë se kaq? Mos të notoj në sipërfaqe, por të zhytem thellë në oqean e të shoh margaritarët që më servir Allahu Fuqplotë. Duhet një agjërim i atillë, që sikur edhe mijëra djaj të më sulen, të mos më fusin dot ndotësinë më të vogël, jo vetëm në mendje, por as në imagjinatë. Natyra njerëzore ka dobësitë, hapësirat e mundshme për të gjitha këto, mirëpo ato duhen mbajtur nën kontroll. Dhe nëse bie pre e këtyre dobësive, besimtari duhet të thotë: "Po kjo çytje e djallit nga doli?" Pastaj duhet të thotë me dhjetëra herë "Estagfirullah.

O Allah! "Nuk të njohëm dot ashtu siç e meriton. Nuk të përmendëm dot aq sa e meriton. Nuk të falënderuam dot ashtu siç e meriton. Nuk të adhuroam dot ashtu siç e meriton." Duhet ndoshta ta artikulojmë mbi 50 herë në ditë pozicionin tonë. Nuk të adhuroam dot Ty ashtu siç duhej, kështu që nuk të meritoam. Nuk të përmendëm e lavdëruam dot ashtu siç duhej. U bëmë shembuj të këqij. Bëmë të lindë Islamofobia. Ua dhamë vetë këtë të drejtë atyre që të na cilësojnë në këtë mënyrë.

Njeriu i kohëve tona jetoi fatkeqësisht i panjohur me bukuritë e Islamit. Nuk i panë dot sjelljet dhe qëndrimet e mirëfillta prej myslimani. Prandaj, detyra jonë më parësore

është, që me strukturën tonë familjare, në lidhjet me nënën, babanë apo fëmijët, me ftesat tona, t'u tregojmë atyre Islamit e vërtetë porsì fisnikë. Nëse disa njerëz e shohin Islamit si gogol, rruga për ta kapërcyer këtë keqkuptim është formimi i një shoqërie të sinqertë me ta. Myslimanët, gjatë muajit të bekuar të Ramazanit, sipas pozicionit të tyre, duhet ta përdorin sa më frytshëm mendjen, logjikën, gjykimin dhe këshillimin, në mënyrë që ta realizojnë sa më mirë këtë punë.

Ramazani, për të gjithë ne, për të gjithë popullin, për të gjithë botën Islame, na bëftë të fitojmë afërsi me Allahun (xh.sh.). T'i fusim të agjërojnë të gjitha organet dhe ndjesitë tona. Kjo është fillimisht detyrë e jona, por njëkohësisht edhe e drejtë e Allahut. Detyrë për t'ua bërë njerëzve Islamit të dashur. Një detyrë për t'i bërë njerëzit që ta duan Allahun (xh.sh.).

Le të mendojë secili për vete se çfarë mund të bëjë unë që t'ua bëjë Zotin të dashur njerëzve! T'i bëjë të duan ato gjëra që do Allahu (xh.sh). Si mund t'ia arrij kësaj që ata të thonë: "Ja, kjo qenka jeta e vërtetë!" Në të kundërt, të mos thojnë: Ja, këta janë myslimanët!" Të mos mërzhiteshin e të hidhëroheshin prej nesh. Të mos vihen në pritje të ditës së rrënimin tonë. Duhet të shfaqim një trajtë të atillë, që njerëzit të thonë: "Aman, të mos ikin këta njerëz, sepse më ikjen e këtyre shuhen pishtarët, fiken llambat për njerëzimin, duke ngelur krejt në errësirë." Që me lejen dhe ndihmesën e Allahut, Profeti të jetë bërë i dashur për njerëzit. Të mund të bëjmë të dashur atë Shpirt Bamirës. Ky Ramazan na ktheftë në formën e përshtatshme për t'ua bërë edhe njëherë vetvetja e për t'ua bërë shembull, me thellësitë e bamirësisë dhe mëshirës së tij. Na ktheftë dhe na dhëntë trajtë! Allahu na ka krijuar në trajtën më të përkryer për të arritur përsosmërinë, prandaj ky muaj i bekuar na bëftë të mundur që t'i japim hakun kësaj trajte.

Muaji i Ramazanit është një rast i mirë për ata të cilët dëshirojnë të gjejnë veten dhe të vazhdojnë rrugën e udhëzimit, për t'ua afruar Allahut me vepra të mira, duke harruar armiqësinë, urrejtjen, inatin dhe egoizmin, e duke marrë pjesë në tubime ku jepen këshilla dhe adhurohet Zoti Fuqplotë. Inshallah Ramazani shkon i begatë. Teravitë përftojnë begati. Inshallah, ashtu siç e kemi izoluar gojën nga të ngrënit dhe të pirët, të mos hyjmë në mëkate, të mos artikulojmë fjalë negative, të mos përgojojmë, të mos shpifim, të mos i afrohem gënjeshtres, po ashtu të mos përfshihemi në kurrfarë mashtrimi apo manipulimi. T'i qëndrojmë larg haramëve dhe të shumojmë adhurimet e veprat e mira. Kjo sjellje do të na përftojë një mënyrë të jetuarit prej besimtari të vërtetë. Atëherë me plot gojën themi: "Oh, sa mirë që e kuptuam Ramazanin!"

Në të kundërt, Ramazani ashtu siç hyri, del, e nëse dhe ne dalim prej tij ashtu siç hymë, më kot do të jemi lodhur gjatë tij. Do të kemi përjetuar lodhjet e gjatë këtij muaji më kot. Këtë nënkupton fjala e të dërguarit të Allahut kur thotë: "Ka shumë njerëz që agjërojnë, e nga kjo nuk kanë asgjë, përveç urisë dhe etjes. Ka shumë njerëz që luten natën, e asgjë nuk ka nga kjo lutje, përveç pagjumësisë. I tillë është çdo njeri, i cili nuk e kryen këtë veprim me besnikëri dhe sinqeritet të plotë." (Ibn Maxhe, Sijam, 21.)

01 KMSH VLERËSON AMBASADORIN E MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE, SH.T.Z. FAISAL GHAZI HIFZI



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë zhvilloi një ceremoni vlerësimi në nder të Ambasadorit të Mbretërisë së Arabisë Saudite në Shqipëri, Sh.T.Z. Faisal Ghazi Hifzi.

Gjatë kësaj ceremonie, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i dorëzoi personalisht Ambasadorit Hifzi një medalion dhe një certifikatë vlerësimi, me motivacionin: "Për kontributin e çmuar në forcimin e marrëdhënieve dhe mbështetjen e projekteve për zhvillimin fetar, social dhe kulturor, si dhe promovimin e solidaritetit dhe miqësisë midis dy popujve."

Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, morën pjesë përfaqësues të trupës diplomatike të vendeve Arabe në Shqipëri, Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet, z. Klodjan Bulku, Drejtori i Zyrës Rajonale të Ligës së Botës Islame (Rabitas) në Bosnje-Hercegovinë, z. Abdullah Qari, përfaqësues të lartë të Kolegjit Universitar "Bedër", myftinjtë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, drejtues shoqatash të ndryshme, etj.

Ceremonia u hap me leximin e disa ajeteve kuranore nga Drejtori i Arsimit në KMSH, z. Elton Karaj.

Fill pas tij, fjalën e mori Kryetari Spahiu, i cili falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe u ndal në vlerësimin e figurës dhe kontributit të Ambasadorit Hifzi në Shqipëri.

Më pas, ai i dorëzoi Ambasadorit certifikatën dhe medalionin e përgatitur enkas për këtë rast.

Ceremonia vijoi më tej me fjalën e rastit të Ambasadorit Hifzi, i cili falënderoi përzemërsisht Komunitetin Mysliman të Shqipërisë për këtë vlerësim dhe përmendi disa nga momentet më të veçanta të shërbimit të tij si Ambasador në vendin tonë.



02 KËSHILLTARI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË "RAHMA GLOBAL SOCIETY" VIZITON KMSH-NË



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në selinë e institucionit, z. Khaled AlMulla, Këshilltar i Drejtorit të Përgjithshëm të "Rahma Global Society" nga Kuvajti, një organizatë ndërkombëtare bamirëse dhe humanitare, i shoqëruar ky i fundit nga z. Korab Kaja, Drejtor i Fondacionit "Mirësia" në vendin tonë.

Në fjalën e tij, Kryetari Spahiu i uroi mirëseardhjen delegacionit dhe i njohu ata shkurtimisht me institucionin e KMSH-së, strukturat e tij dhe kontributin e rëndësishëm fetar, edukativ dhe social që ky institucion ofron në shoqërinë tonë.

Ndërkohë, z. Khaled AlMulla falënderoi Kryetarin Spahiu për mikpritjen dhe vlerësoi përpjekjet dhe punën e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në ringritjen e shumëdimensionale të Islamit në Shqipëri.

Një moment kyç i këtij takimi ishte nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Rahma Global Society, që ka për qëllim realizimin e projekteve të përbashkëta në fushat e mirëqenies sociale, edukimit dhe zhvillimit të besimit islam.

Bashkëbisedimi ndërmjet palëve u shtri më tej në disa projekte të ndryshme konkrete, veçojmë këtu edhe kompleksin multifunksional të xhamisë së Delvinës.



03 MBLEDHJE PUNE ADMINISTRATORËT E QARQEVE



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë zhvilloi një mbledhje të rëndësishme me administratorët e qarqeve, ku u diskutuan çështje kyçe për menaxhimin dhe përmirësimin e shërbimeve fetare dhe administrative. Në takim morën pjesë Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Kancelari i institucionit, z. Fejzi Shaholli, drejtues të sektorëve kryesorë si financat, vakëfet dhe çështjet juridike, si dhe administratorët e qarqeve.

Në fjalën e tij hapëse, kryetari Spahiu, theksoi rëndësinë e koordinimit të strukturave të institucionit për të përmirësuar shërbimet dhe për të adresuar nevojat e besimtarëve, veçanërisht në prag të muajit të bekuar të Ramazanit.

Më tej, Drejtori i Financave, z. Edison Hoti, prezantoi raportet financiare dhe u ndal në procesin e anëtarësimeve të këtij viti, fondeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si dhe menaxhimin e zekatit dhe burimeve të tjera ekonomike për të mbështetur projektet institucionale në vazhdim.

Drejtori i Vakf-Investimeve, z. Erlis Moshë, në fjalën e tij u ndal tek investimet strategjike në prona, unifikimi i kontratave të qirave dhe sipërmarrjeve, si dhe avancimi i programit e-Vakf me dokumentacionet e nevojshme për një administrim më të mirë të këtyre pasurive.

Ndërkohë, përgjegjësi i zyrës juridike në KMSH, avokat Arjan Muça, trajtoi çështjet e legalizimit dhe regjistrimit të pronave me vërtetim pronësie, si dhe ndjekjen e dosjeve të ATP dhe proceseve gjyqësore të hapura, duke theksuar domosdoshmërinë e zgjidhjeve ligjore efektive për mbrojtjen e interesave të institucionit.



04 KS RELIEF DHURON 25 TON HURMA ARABE PËR BESIMTARËT



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me qendrën Mbreti Selman për Bamirësi dhe Ndihma Humanitare dhe me koordinimin e ambasadës së Arabisë Saudite në Tiranë, zhvilluan në ambientet e KMSH-së, ceremoninë e inaugurimit të projektit të dhurimit të 25 ton hurmave arabe nga Mbreti i Arabisë Saudite, Selman Bin AbdulAziz.

Në këtë ceremoni, morën pjesë, Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, z. Fajsal Gazi Hifdhi, z. Falih bin Abdullah es-Seb'îl, Drejtor projektesh pranë qendrës KS Relief, si dhe përfaqësues të tjerë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe ambasadës së Arabisë Saudite në Tiranë.

Në fjalën e tij të rastit, kryetari Spahiu shprehu vlerësimet dhe falenderimet më të sinqerta për të gjithë ata që i dhanë jetë këtij projekti. Ndërkohë, Ambasadori Hifdhi, pasi falënderoi të gjitha palët që bënë të mundur realizimin e kësaj nisme, u shpreh se projekte të tilla të vazhdueshme janë tregues i marrëdhënieve të forta ndërmjet dy vendeve dhe popujve tanë.

Në fund, mbajti një fjalë përshëndetëse edhe përfaqësuesi i qendrës KS Relief i cili theksoi fokusin e organizatës së tij në zgjerimin e këtyre projekteve në vendin tonë nëpërmjet bashkëpunimit me KMSH dhe bashkërendimit me Ambasadën Saudite.

Ky projekt, i kthyer tashmë në traditë disa-vjeçare, thekson angazhimin e përbashkët për solidaritet dhe mirëqenie, duke forcuar më tej marrëdhëniet mes institucioneve të përfshira.



05 ZHVILLOHET AKTIVITETI I PËRBASHKËT SPORTIV "KUPA E RAMAZANIT"



Drejtorja e Thirrjes dhe Mesazhit Islam dhe Drejtorja e Marrëdhënieve me Xhematin në KMSH, zhvilluan aktivitetin e përbashkët sportiv më fëmijët e kurseve fetare të disa xhamive në Tiranë.

Kupa u zhvillua në dy kategori grupmoshash, deri në 13 vjeç dhe mbi këtë limit moshe.

Për kategorinë deri në 13 vjeç, finalja u nda ndërmjet fëmijëve të xhamisë "Ali Demi" dhe xhamisë "Kokonozi", ndërsa finalja e kategorisë mbi 13 vjeç, u luajt ndërmjet fëmijëve të xhamisë "Nura" dhe xhamive "Kombinat".

Fitues u shpallën fëmijët e xhamisë "Ali demi" dhe xhamisë "Nura".

Pas përfundimit të ndeshjeve programi vijoi me faljen e përbashkët të namazit të drekës në xhaminë e re "Kombinat".

Për të vijuar më tej me disa këshilla të ndryshme mbi edukimin Islam tëk fëmijet nga hoxhallarët e pranishëm, veçojmë këtu z. Erjol Haxhiu dhe z. Shpëtim Seranaj, drejtorët përkatës të dy drejtorive të lartpërmendura, të cilët organizuan dhe u kujdesën për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti.

Një pikë majft e rëndësishme ishte edhe shpërndarja e dhuratave për ekipet fituese, për ekipet e vendeve të dyta dhe lojtarët më të mirë të kupës.

Në fund të kësaj maratone sportive, fëmijët dhe hoxhallarët e pranishëm, konsumuan një drekë të përbashkët në ambientet e xhamisë së re "Kombinat".



06 PROGRAMI ARTISTIK KUSHTUAR VLERAVE TË MUAJIT TË BEKUAR TË RAMAZANIT



Medreseja e Tiranës zhvilloi një program artistik kushtuar vlerave të muajit të bekuar të Ramazanit.

Krahës ilahive, numrave teatralë dhe poezive të ndryshme dedikuar mirësive dhe begatave të këtij muaji të shenjtë, përgatitur dhe performuar nga vetë nxënësit e Medresesë, ky program përmbante edhe fjalën përshëndetëse të Nënkrjetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica dhe Drejtorit të Medresesë së Tiranës, z. Ndrçim Gjimi.

Mbrëmja u çel me leximin e disa ajeteve Kuranore, të sjella për të pranishmit e shumtë nga hafizi Enes Hyka.

Për të vijuar më tej me fjalën përshëndetëse të Drejtorit të Medresesë, i cili pasi falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, përgëzoi nxënësit për këtë iniciativë kaq të bukur në organizimin e kësaj mbrëmjeje dhe i uroi të gjithë një agjërim të lehtë e të pranuar.

Ndërkohë Nënkrjetari Bica, në fjalën e tij të rastit preku disa nga veçantitë e këtij muaji të bekuar, duke e cilësuar atë si një kohë reflektimi, përmirësimi, afrimi me Zotin, me familjen dhe me njerezit që na rrethojnë.

"Ramazani është një shkollë e madhe për shpirtin dhe për karakterin tonë. Në këtë muaj ne mësojmë të jemi më të vetëdijshëm për fjalët dhe veprimet tona, të tregojmë më shumë dhembshuri dhe dashuri ndaj të tjerëve, të shtojmë adhurimet tona, e gjithashtu të kalojmë më shumë kohë me familjen, të afërmit dhe të tregohemi më të vëmendshëm ndaj shtresave në nevojë" – theksoi ai gjatë fjalës së tij.

Në këtë mbrëmje festive morën pjesë nxënës, prindër, drejtues e përfaqësues institucionesh të ndryshme si dhe të ftuar të shumtë.



Kur adetet bëhen ibadete

Krijuesi i gjithësisë, Zoti ynë i Madhërishtëm, e ka dërguar njeriun në tokë si mëkëmbës. Allahu i Madhëruar nuk i ka lënë njerëzit të braktisur, por për të rregulluar jetën e tyre personale dhe shoqërore, ka shpallur Kur'anin Famëlartë dhe ka dërguar një udhërrëfyes, një Pejgamber, i cili do t'ua shpjegonte dhe mësonte atë libër të lavdishëm në mënyrën më të bukur. Ai që e njeh më së miri Kur'anin, është gjithashtu ai që mund ta interpretojë atë në mënyrën më të drejtë. Njëherë, kur i ishte drejtuar një pyetje për moralin e të Dërguarit (a.s.), Aishja (r.a.) u përgjigj: **"Moral i tij ishte Kur'ani."** I përshkruar me këtë cilësi, i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) është udhërrëfyesi më i mirë për ne në shpjegimin e Kur'anit Famëlartë dhe Islamit. Në Kur'an thuhet: **"Sot e përsosa për ju fenë tuaj, e plotësova ndaj jush dhuntinë Time dhe zgjodha për ju Islamin si fe."** (Sureja el-Maide, 5:3) Me këtë shpallje, për njerëzimin u zgjodh Islami si fe, dhe për ta përcjellë atë, u dërgua Muhamed Mustafaja (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Falë këtij Udhërrëfyesi të Madhërishtëm, njerëzit do të përqipen të bëhen njerëz ashtu siç dëshiron Allahu i Madhëruar dhe të fitojnë kënaqësinë e Tij.

Për ta arritur këtë, Allahu i Madhëruar, në shumë vende në Kur'an, ka kërkuar që njerëzit t'i binden dhe ta pasojnë të Dërguarin e Tij. Në një ajet kur'anor thuhet: "O i Dërguar, thuaju: 'O njerëz, nëse e doni Allahun, atëherë më pasoni mua që edhe Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë mëkatet tuaja. Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.'" (Sureja Al-i Imran, 3:31) Me këtë shpallje, theksohet se pasimi i të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) përfundimisht sjell bindjen ndaj Allahut dhe dashurinë e Tij.

Pra, nëse duam të jemi besimtarë të vërtetë dhe të fitojmë kënaqësinë e Allahut, duhet ta pasojmë të Dërguarin e Tij dhe të përqipemi të jetojmë ashtu siç ka jetuar ai. Për këtë arsye, është e domosdoshme të njihen mirë jeta dhe Suneti i tij fisnik. Dijetarët muslimanë, që nga periudhat e hershme, e kanë klasifikuar Sunetin sipas shkallës së detyrueshmërisë dhe kanë shkruar shumë vepra mbi këtë çështje. Në librat e Usulu'l-Fikhut, theksohet se në jetën e tij të bekuar, i Dërguari i Allahut (a.s.) ka pasur udhëzime, ndalesa, këshilla dhe orientime në shumë fusha - si pejgamber, si kryetar i familjes, si komandant ushtarak dhe në



role të tjera. Dijetarët e fikhut kanë sqaruar se fjalët dhe veprimet e tij që lidhen me çështje fetare janë detyruese (pra, duhet të zbatohen), ndërsa ato që kanë të bëjnë me natyrën njerëzore dhe nevojat fizike nuk janë të detyrueshme. Megjithatë, nëse dikush i ndjek këto sunete, do të fitojë shpërblim, ndërsa lënia e tyre nuk përbën mëkat.

Por, këndvështrimi i Bediuzaman Said Nursiut ndaj këtyre llojeve të suneteve, që i përkasin etikës dhe sjelljeve (adab), është shumë i ndryshëm. Ai i ka parë këto sunete (traditat profetike) me një qasje pozitive. Pra, ai nuk i ka vlerësuar nga këndvështrimi "Po nuk i ndjeka nuk kam ndonjë gjynah, prandaj mund t'i lë.", por nga këndvështrimi "Nëse i zbatoj me një qëllim të pastër, do të fitoj shpërblim." Ndërsa disa njerëz kanë menduar t'i lënë këto sunete, ai ka parë në to një mundësi për të fituar sevape të ndryshme. Në lidhje me këtë çështje, ai shprehet kështu:

"Suneti i lavdishëm (sunnat-i thenijje) ka tre burime kryesore: 1) Fjalët e të Dërguarit të Allahut 2) Veprimet dhe 3) Gjendjet e tij.

Këto tre kategori ndahen në tre grupe: 1) Farze (detyrimet) 2) Nafile (veprat vullnetare) 3) Adetat e bukura (zakonet e mira).

Pjesa që përfshin farzet dhe vaxhibet është e detyrueshme për t'u ndjekur. Nëse ato lihen, sjellin dënim dhe ndëshkim.

Pjesa nafile ndahet në dy kategori:

Një pjesë përfshin sunetet e lidhura me adhurimet. Ndryshimi i tyre konsiderohet bidat. (Megjithëse lënia e tyre nuk sjell ndëshkim, ndjekja e tyre sjell shpërblim të madh. Pjesa tjetër quhet adab (etikë dhe sjellje e mirë). Kundërshtimi i këtyre nuk quhet bidat, por megjithatë përbën një lloj mospajtimi me sjelljet e të Dërguarit të Allahut dhe privon nga përfitimi prej dritës dhe udhëzimit të tij. Kjo kategori përfshin veprimet e përditshme që lidhen me kulturën, traditën dhe natyrën njerëzore, siç janë të ngrënit dhe të pirët. Pasimi i veprimeve të të Dërguarit të Allahut (a.s) në këto çështje konsiderohet pjesë e etikës profetike. Për shembull, ka shumë sunete që shpjegojnë etikën e të folurit dhe normat e sjelljes. Këto sunete klasifikohen si adab. Kush i ndjek këto rregulla të etikës, e shndërron traditën e tij në adhurim dhe përfiton një dritë të madhe shpirtërore prej tyre. Madje, ndjekja edhe e një adabi të vogël ia përkujton njeriut të Dërguarin e Allahut dhe i sjell zemrës një nur të veçantë.

3) Zakonet dhe veprimet e mira, për shkak të urtësisë dhe dobive që ato sjellin, janë shumë të vlefshme për individin dhe shoqërinë që t'i ndjekin dhe t'u binden. Sepse, në çdo veprim të zakonshëm ka dobi dhe përfitime, dhe kur ndiqen këto norma etike dhe tradita të mira, ato marrin vlerën e adhurimit.¹

Përveç të gjitha këtyre, "qëllimi i pastër" është gjithashtu shumë i rëndësishëm në veprimet që kryejmë. Prandaj, mund të themi: "Pasimi me nijet të pastër i sunetit i kthen adetet në ibadete." Këtu bien në sy tre fjalë kyçe. Nëse këto tre fjalë shpjegohen, do të kuptohet se si mund të fitojmë shpërblim nga një veprim i zakonshëm.

a) Ibadet: Do të thotë të drejtohesh me zemër dhe dëshirë ndaj Allahut, të përulësh dhe t'i bindesh Atij, duke e adhuruar sinqerisht. Adhurimet përcaktojnë marrëdhënien midis njeriut dhe Allahut. Në librat e fikhut, ato ndahen në kategori të ndryshme. Disa prej tyre janë: pastrimi (tahareti), abdesi, gusli, tejemumi, namazi, agjërimi, haxhi, zekati, premtimi (adak)² dhe kurhani.

b) Adab: Fjala "adab" është shumë e fjalës arabe "edeb"³, që do të thotë "moral i mirë, edukatë e bukur, delikatesë, sjellje e mirë".⁴ Në këtë kuptim, adab përfshin rregullat dhe parimet e sjelljes së mirë, edukatës dhe

finesës që duhet të ndiqen për të pasur një karakter të ndritur. Ne e përdorim fjalën adab (ose adet: zakon) për të përshkruar çdo veprim jashtë adhurimit që bëjmë gjatë 24 orëve të ditës, përveç ibadeteve.

Imam Shatibiu i ka ndarë adetet në dy lloje sipas mënyrës se si zhvillohen:

1. Adete që nuk ndryshojnë sipas kohës, vendit dhe situatës: Këtu përfshihen gjëra të tilla si të ngrënit, të pirët, të gëzuarit, të qenët i trishtuar, të fjeturit, të zgjuarit, të ndjekurit e dëshirave të natyrshme dhe të tërhequrit nga ato gjëra që nuk janë të përshtatshme, si dhe marrja e gjërave të pastra, të bukura dhe të shijshme.

2. Adete që ndryshojnë sipas kohës, vendit dhe situatës: Këtu përfshihen shembuj si forma e veshjes dhe mbulesës, mënyra e jetesës, butësia në situata të dhunshme, ashpërsia në situata të buta, lëvizja e ngadaltë apo e shpejtë në veprime, etj.⁵

c) Nijet: Do të thotë "të kalosh në zemër dëshirën për të bërë një veprim për kënaqësinë e Allahut." Sipas fesë sonë, veprimet marrin vlerë në përputhje me qëllimin tonë. Në lidhje me këtë, një hadith i shënuar nga Umeri (r.a) thotë: *"Veprimet (nuk vlerësohen ndryshe) përveçse sipas qëllimeve; çfarëdo që është qëllimi i dikujt, ai do ta marrë atë që ka synuar. Nëse dikush bën hixhret për Allahun dhe të Dërguarin e Tij (për kënaqësinë dhe miratimin e Atij), hixhreti i tij do të konsiderohet si emigrim për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Nëse dikush emigron për një fitim të përkohshëm të kësaj bote (si një përfitim material) ose për të marrë një grua në martesë, hixhreti i tij do të konsiderohet në përputhje me atë që ka synuar."*⁶

Që një veprim të sjellë shpërblim, ai duhet patjetër të jetë i urdhëruar ose i ndaluar nga i Madhëruari Allah ose nga i Dërguari i Tij (a.s.). Veprimet e tilla përfshihen në kategorinë e adhurimeve. Për shembull, Allahu në Kur'anin Famëllartë, lidhur me namazin, thotë: "Vërtet, namazi është obligim i caktuar për besimtarët në kohë

5. Shatibi, Muvafakat, 2/297.

6. Buhari, Iman, 41; Muslim, Imare, 155.

1. Bediüzzaman Said Nursî, Lem'alar.

2. Në gjuhën arabe, nedhir (premtimi) i referohet adakut, që në terminologjinë e fikhut do të thotë "kur një person, megjithëse nuk është i obliguar sipas fesë, e bën një adhurim të detyrueshëm për veten e tij". Me fjalë të tjera, adaku është "kur një person, edhe pse nuk është i detyruar, premtim para Allahut të Lartësuar të kryejë një adhurim nga farzet ose vaxhibet dhe e bën këtë adhurim një detyrim për veten e tij". P.sh., ai thotë "Beto hem se këtë ramazan do fal 100 rekate". Ky lloj premtimi behet obligim për të që ta përmbush (shënim i përkthyesit).

3. Mehmet Doğan, Büyük Türkçe Sözlük, fq. 320.

4. Mehmet Doğan, Büyük Türkçe Sözlük, fq. 10.

të përcaktuara.” (Sureja en-Nisa, 4/103). Nëse ne i përmbahemi këtij urdhri dhe falim namazin, fitojmë shpërblim, ndërsa ata që nuk e zbatojnë, bëhen mëkatarë. E njëjta gjë vlen edhe për agjërimin, haxhin, zekatin dhe madje edhe për veprat më të vogla të mira. Nga ana tjetër, ka edhe gjëra të ndaluara. Për shembull, ata që i përmbahen ndalimit të konsumimit të alkoolit, vrasjes së njerëzve dhe veprave të tjera të ndaluara, do të fitojnë shpërblim, ndërsa ata që nuk i zbatojnë këto ndalesa, do të bien në gjynah.

Përveç këtyre, veprimet tona kanë të bëjnë me etikën dhe sjelljet e mira. Këto janë veprime që në kushte normale janë të lejuara (mubah), pra nuk kanë as shpërblim e as gjynahe. Për shembull, të hash, të pishë ujë, të flesh, etj. Që një person të fitojë shpërblim ose të bjerë në mëkat nga këto veprime, varet nga qëllimi me të cilin i kryen ato. Për shembull, nëse një person pi një gotë ujë me qëllimin e konsumimit të alkoolit, ai bie në mëkat. Nga ana tjetër, nëse një besimtar pi ujë pa pasur synimin që t’i përmbahet një praktike profetike, atëherë ai thjesht ka shuar etjen, pa fituar as shpërblim e as gjynah. Por nëse dikush pi ujë duke ndjekur sunetin e Pejgamberit – pra, e kap gotën me dorën e djathtë, thotë “Bismilah” para se të pijë, e pi në tre gllënjka, etj. – atëherë ai fiton sevap për këtë veprim. Po ashtu, nëse një person shtrihet për të fjetur mbi krahun e djathtë, vendos dorën e djathtë nën faqe, lexon lutje, fryn në duar dhe më pas fërkon trupin, atëherë edhe ky veprim i sjell atij shpërblim. Në përfundim, nëse një person i shndërron këto veprime të zakonshme të përditshme në akte adhurimi, ai i jep vlerë shpirtërore çdo aspekti të jetës së tij. Kjo është si një “art i shndërrimit të hekurit në ar”. Për të fituar shpërblimin e adhurimit edhe nga një veprim që duket krejt i zakonshëm, duhet t’i përmbahemi kësaj formule.

Në përfundim, themi se të gjithë dëshirojnë të shkojnë në Xhenet. Për këtë arsye, përpiqemi të përgatitemi duke falur pesë kohët e namazit gjatë ditës, që në total zgjasin rreth një orë. Pra, duam

të fitojmë Xhenetin me vetëm një orë adhurim brenda 24 orëve. Megjithatë, nëse e zbatojmë këtë formulë në jetën tonë, mund t’i kthejmë edhe 23 orët e mbetura në adhurim. Në këtë mënyrë, e gjithë dita jonë do të jetë e mbushur me adhurim. Për ta arritur këtë, fillimisht duhet ta njohim këtë formulë dhe më pas të përpiqemi të mësojmë çdo aspekt të jetës së ndritur të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Kështu, do ta jetojmë jetën sikur të jemi gjithmonë në adhurim...

Në shkencat islame, ekzistojnë disiplina që trajtojnë dhe studiojnë aspekte të ndryshme të jetës dhe misionit të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Do të jetë e përshtatshme t’i përmendim shkurtimisht këto disiplina.

Hadithi: Është disiplina që merret me fjalët, veprat dhe miratimet e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Sijer: Është shumësi i fjalës arabe sire dhe përdoret për të përshkruar jetën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), nga lindja deri në vdekjen e tij. Megazi: Është disiplina që trajton luftërat e të Dërguarit të Allahut dhe përfshin hadithet që lidhen me to. Në fakt, është një pjesë e Sires, por fokusohet vetëm në ekspeditat dhe betejat e tij. Shemail: Merret me moralin, karakterin, fizikun, stilin e jetesës dhe veshjes, si dhe jetën e tij private, duke trajtuar aspektet njerëzore të personalitetit të të Dërguarit të Allahut. Delail: Ndërsa Shemaili trajton aspektet njerëzore të të Dërguarit të Allahut, Delaili fokusohet në profetësinë e tij, duke sjellë dëshmi për këtë dhe duke trajtuar mrekullitë e tij.

Nëse e studiojmë në mënyrë të thellë jetën e shembullit më të bukur dhe më të përsosur dhe njohim sjelljet e tij, atëherë do ta kemi më të lehtë t’i praktikojmë ato. Përmes kësaj, edhe veprimet që në kushte normale nuk sjellin shpërblim – si të ngrënit, të pirët, të fjeturit, të ulurit apo shkëmbimi i dhuratave – mund të bëhen burim shpërblimi për ne.

**Përktheu nga gjuha turke
Haki Sahitaj**

Muaji i Madhërishtëm i Ramazanit përmes pyetjeve II

Çfarë është Nata e Kadrit dhe çfarë vlere ka ajo?

Nata e Kadrit është një natë e veçantë në vitin kalendarik hënor. Mundësia më e madhe është që ajo të gjendet në Muajin Ramazan, sidomos në netët teke të 10 ditëshit të fundit. Në Kuran ka një sure enkas për Natën e Kadrit, ku përmenden vlerat e saj. Në suren Kadr thuhet:

"Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj! Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) zbresin engjëjt dhe Shpirti (Xhibrili (a.s)) për secilën çështje. Ajo është paqe deri në agim të mëngjesit." (Kadr, 97/3-5)

Profeti (s.a.s) ka thënë: "Ai që e kalon Natën e Kadrit me adhurim duke besuar me zemër për vlerën e saj dhe që Allahu do t'ia japë shpërblimin, i falen të gjitha gjynahet e mëparshme" (Buhari, 1910; Muslim, 760).

Kur është Nata e Kadrit dhe si ta arrish atë?

Nata e Kadrit është lënë e fshehtë. Shumica e transmetimeve prej Profetit Muhamed (a.s) mbështesin mendimin që nata e Kadrit ndodhet në 10 netët e fundit të Ramazanit. Në disa hadithe të tjerë rrethi ngushtohet më shumë, duke përmendur si më të mundshme netët teke. Profeti (a.s) ka shprehur edhe disa shenja nëpërmjet të cilave njerëzit me ndjeshmëri të lartë shpirtërore, mund ta dallojnë këtë natë të bekuar. Nisur nga kjo disa dijetarë kanë shprehur mendimin, që Nata e Kadrit ka qëlluar më shpesh në 27 Ramazan. Prandaj në vendin tonë 27 Ramazan është pranuar si simbol i Natës së Kadrit. Besimtari duhet të jetë në kërkim të kësaj nate, për ta arritur atë. Ndërkohë që Ebu Hanife thekson se ajo duhet kërkuar çdo natë të vitit.

Çfarë të bësh Natën e Kadrit?

Çdo aktivitet fetar si namazi, këndimi i Kuranit, bërja e duasë, etj, është i mirëpritur në Natën e Kadrit. Kur Aishja (r.anha) ka pyetur Profetin (a.s) se çfarë të bëjmë nëse arrijmë Natën e Kadrit, Ai (a.s) është përgjigjur kështu: Lutju Allahut me këto fjalë "Allahumme inneke afuvvun, tuhibbul'afue fa'fu anni." (Zoti im! Ti je Falës, të pëlqen të falësh, më fal dhe mua!)

Çfarë është sadakaja e fitrit?

Sadakaja e fitrit, ndryshe e quajtur "Sadakatu'l-fitr" ose "zekatu'l-fitr" është një adhurim material, të cilin e kanë detyrim myslimanët, që arrijnë Fitër Bajramin. Ata detyrohen të japin sadakanë e fitrit për veten dhe për kë kanë nën kujdestari.

Cili është gjykimi rreth sadakasë së fitrit?

Si dispozitë islame, sadakaja e fitrit është e kategorisë së detyrimit/vaxhib. Por sipas Hanefive vaxhib e kanë vetëm ata të cilët plotësojnë kriterin e nisabit. Thënë më thjeshtë, kush ka detyrim zekatin ka detyrim edhe sadakanë e fitrit. Sipas medhhebeve të tjerë praktikisht e ka detyrim çdo mysliman që zotëron sasinë e kësaj sadakaje, përveç nevojave bazike të familjes.

Kujt mund t'i jepet sadakaja e fitrit dhe kujt jo?

Personat ose institucionet që kanë të drejtë ta pranojnë zekatin, mund ta marrin edhe sadakanë e fitrit, sepse atyre që iu takon zekati, iu takon edhe sadakaja e fitrit. Sadakaja e fitrit nuk mund t'i jepet personave që konsiderohen fetarisht të pasur, pra që zotërojnë sasinë e nisabit. Gjithashtu, nuk mund t'i jepet bashkëshortes; paraardhësve të vet: babait, nënës, gjyshit dhe gjyshes;



pasardhësve të vet: djalit, vajzës, nipit, mbesës dhe të tjerëve, që i ka nën kujdestarinë e tij. Me rastin e dhënies së sadakasë së fitrit, duhet t'i jepet përparësi të varfërve që jetojnë pranë, më pas mjedisit më të gjerë ku jeton, farefisit që mund të banojë edhe larg, të varfërve me sjellje morale të mirë, si dhe nxënësve nevojtarë.

Sa është vlera e sadakasë së fitrit?

Vlerën e sadakasë së fitrit e ka përcaktuar Pejgamberi (a.s), kur ka thënë: "Një sa' (njësi matëse e peshës) me hurma ose me elb, ose gjysmë sa' me grurë". Një sa' është e barabartë me 3.350 kg. Me fitrin është synuar të plotësohet ushqimi një ditë dhe një të varfri, sipas standardeve të shoqërisë ku ai jeton. Kështu, ushqimi minimal një ditë është kthyer në kriterin përcaktues, i cili është përkthyer në vlerë monetare, duke qenë më praktik për shoqëritë aktuale. Nisur nga kjo çdo institucion përfaqësues dhe përgjegjës për çështjet e myslimanëve përcakton çdo vit shumën në vlerë monetare. Në Shqipëri ky institucion është Komuniteti Mysliman i Shqipërisë.

Kur duhet dhënë sadakaja e fitrit dhe si të veproj, nëse nuk e kam dhënë deri ditën e bajramit?

Sadakaja e fitrit mund të jepet që me hyrjen e muajit të Ramazanit, por më mirë është të jepet në pjesën e tretë të tij. Sadakaja e fitrit ka një lidhshmëri me festën e Bajramit. Nxjerrja/veçimi e saj pranohet deri para faljes së namazit të Bajramit. Edhe sikur mos ta ketë dhuruar, personi duhet ta ketë ndarë sasinë që do të dhurojë si sadaka e fitrit para bajramit. Nëse dhënien e saj e vonon pas faljes së namazit të Bajramit, kjo nuk e rrëzon detyrueshmërinë, përkundrazi

ai detyrohet që ta japë sa më shpejt, duke bërë pendim për shkak të vonimit.

Çfarë është itikafi dhe si bëhet?

Itikaf është një adhurim i veçantë, i cili do të thotë të qëndrosh në xhami me qëllim të përkushtimit në adhurim, duke qenë agjërueshëm. Itikafi gjatë dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit është prej veprave që konsiderohen sunet muekede – i fortë. Personi, i cili qëndron në itikaf, mund të dalë nga xhamia vetëm sa për të kryer nevojat fiziologjike, për të marrë abdes ose edhe për tu pastruar, nëse e ka këtë nevojë patjetër. Ai mund të dalë nga xhamia edhe për një arsye fetare, siç është falja e xhumasë ose e bajramit në xhami tjetër, nëse nuk falet në atë ku gjendet. Është i mbyllur ndaj çdo gjëje tjetër.

Si falet namazi i bajramit?

Namazi i bajramit është dy rekate dhe falet vetëm me xhemat. Ai falet porsì namazet e tjerë me dy rekate, por duke shtuar 6 tekbiere, të cilat kryhen si tekbiiri fillestar. 3 prej këtyre bëhen në rekatën e parë menjëherë pas këndimit të Subhanekes. 3 të tjerët bëhen në rekatën e dytë pas këndimit të sures shtesë, pra para rukusë. Ndërkohë që bëhen tekbiert shtesë, duart çohen në lartësinë e veshëve pa i lidhur ato ndërmjet tekbiereve.

A mund të agjërojmë ditën e bajramit?

Bajrami është ditë feste dhe në rastin e Fitër Bajramit kuptimi i saj është përmbyllja me sukses e agjërimit të një muaji të plotë dhe festimi duke qerasur. Kështu që ngrënia dhe pirja konsiderohen elemente thelbësore, prandaj dhe agjërimi në ditët e të dy bajrameve është i ndaluar.

Parimet e edukimit Profetik

DUAJ DHE TREGO MËSHIRË



Maja dhe thelbi bazë i arsimit është dashuria. Dhembshuria është pasqyrimi i dashurisë në jetë dhe i kthyer në veprim. Në këtë aspekt, mëshira / dhembshuria është fryt i dashurisë, dhe dashuria është thelbi i dhembshurisë. Edukimi dhe mësimi janë të paimagjinueshme pa këto dy dinamika themelore. Sepse, përveç zemrës dhe emocioneve, dy dinamikat themelore më efektive që hapin dhe forcojnë mendjen, arsyetimin dhe forcojnë kujtesën janë dashuria dhe dhembshuria. Sepse, nuk është e mundur të bësh njerëz dijetarë dhe mësues pa dashuri, dhe të ngrohësh e hapësh dyert e zemrave ndaj të vërtetave pa dhembshuri. Në fakt, këto dy parime ishin në bazën e kuptimit arsimor të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Ai kishte një qasje me dashuri dhe të dhembshuri ndaj fëmijëve të tij, studentëve të tij dhe shokëve të tij, dhe e rekomandoi gjithashtu këtë:

Duaj për Allahun dhe thuaje!

Edukimi është vepër e dashurisë, dhe shprehja e dashurisë në arsim është një traditë profetike po aq e rëndësishme sa vetë edukimi. Sepse nëse fëmija apo i riu e di që ai është i dashur dhe kjo i shprehet, ai gjithashtu e pëlqen mësuesin dhe mësimin. Përndryshe, dashuria e patreguar nuk mund të japë atë që pritet prej saj dhe nuk mund të kontribuojë në edukim. Kështu që "Nëse them se dua do të humbas autoritetin tim apo mund të llastohen", është e gabuar të mos shprehet dashuria për arsye të tilla. Sepse dashuria e pashprehur shpesh nuk kuptohet,

dhe kjo mund ta shpëtojë nxënësin nga mësuesi dhe mësuesin nga nxënësi. Si rezultat, mësuesit dhe nxënësit në shkollë, prindërit dhe fëmijët në familje bëhen të huaj, edhe pse ndajnë të njëjtin mjedis.

Për këtë arsye, metoda e zbatuar dhe e rekomanduar nga i Dërguari i Allahut në arsimin është të shprehni qartë dashurinë dhe dhembshurinë: "Kur e doni dikë për hir të Allahut, thojani se e doni atë"¹.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) jetoi sipas këtij kriteri që Ai rekomandoi, dhe herë pas here ai e tregonte dashurinë e tij ndaj shokëve të tij dhe fëmijëve të tyre, si dhe ndaj familjes dhe nipërve të tij. Për shembull, ai i mbante nipërit të tij, i përfaqëonte me butësi dhe i puthte. Ai nuk mjaftohej me kaq dhe lutej për ata: "O Zoti im! Ki mëshirë për këta! Unë i dua shumë ata, kam mëshirë për ata, dhe Ti duaji ata!"²

Një herë, ndërsa nipi i tij Hysejri po luante me shokët e tij në rrugë, Profeti ynë e pa dhe e thirri. Ai futet në lojë dhe nuk i bindet thirrjes së gjyshit të tij. Pas kësaj, Profeti ynë, duke qeshur vrapon për ta kapur, e kap nipin e tij dhe e merr atë në krahët e tij. Pasi e ledhatoi Ai (s.a.s.) tha: "Hysejri është prej meje dhe unë jam prej ti. Unë e dua shumë Hysejrin. Ai që e do Allahun, e do atë. Ai është nipi im."³

I Dërguari i Allahut tregoi këtë dashuri edhe në praninë e shokëve të tij dhe bëhej shembull që fëmijët të rriteshin me dashuri. Pasi e vë njerin në gjurin e djathtë dhe tjetrin

1. Tirmidhi, Zuhd 54 (2392); Abu Davud, Edeb 122 (5125).

2. Buhari, Fedâilu's-Sahabe 18; Muslim, Fedailu's-Sahabe 57-59.

3. Ibn Maxhe, Mukaddime 11; Hakim, Mustedrek, III/177.

në gjurin e majtë, Ai po i shikonte ata me dhembshuri. Një nga sahabët, i cili u prek nga kjo foto e ëmbël, tha: "O i Dërguar i Allahut! A i doni shumë? " Profeti ynë (s.a.s.) thotë: "Kush i do ata më do mua! Dhe kushdo që i urren ata, më ka urren mua"⁴.

Pasqyrimi më i dukshëm i dashurisë: Dhembshuria

Aq i rëndësishëm sa është qumështi i gjirit për zhvillimin fizik të fëmijëve, po aq e rëndësishme është dashuria për zhvillimin e tyre shpirtëror. Sepse, është dinamika e dashurisë që do të mbijë dhe rrit të gjitha llojet e mirësisë dhe bukurisë në natyrën e pastër të fëmijës. Por, një dashuri që nuk kthehet në përkujdesje, dhembshuri dhe mëshirë, ka një vlera edukative shumë të vogël sa që mund të quhet e papërfillshme. Me fjalë të tjera, dashuria që bën dobi është ajo e shndërruar në kujdesje, dhembshuri dhe mëshirë. Në këtë aspekt, dhembshuria dhe mëshira janë fryti më i ëmbël dhe më ushqyes i dashurisë. Jeta e Profetit të mëshirës është plot me shumë shembuj në këtë drejtim.

Ndërsa Enesi (r.a) na njehe me këtë aspekt të Tij, ai thotë: "Profeti ynë ishte më i dhembshuri i njerëzve ndaj fëmijëve. Djali i tij, Ibrahim kishte një mëndeshë në rrethinat e Medinës të quajtur Avali. Ndonjëherë më merrte me vete kur shkonte për të vizituar atë. Kur futeshim në shtëpinë e farkëtarit, Ai e përqafonte djalin e tij, e nuhaste, e puthte dhe pasi kalonte një kohë me të, ktheheshim."⁵

Enesi rrëfen një ngjarje tjetër, që ai e kishte vënë re, si vijon: "Një herë e pashë Profetin ndërsa po predikonte në ditën e xhuma. Unë pashë që Hasani ishte mbi gjurin e tij. Ai thoshte: "Unë e dua shumë këtë"⁶.

Një person që tregonte dhembshuri edhe në faljet me xhemat!

I Dërguar i Allahut (s.a.s.) nuk e linte pas dore dhembshurinë e tij ndaj fëmijëve as në kohën e adhurimit, Ai tregonte interes dhe dhembshuri për ta aq sa nuk i prishej namazi. Për shembull, kur po shkonte njëherë në xhami për të drejtuar namazin e jacisë, ai kishte sjell me vete një nga nipërit e tij. Kur fillo namazin, fëmija ulet pranë tij, por kur arrin në sexhde, fëmija hipën në shpinë. Kur e zgjati sexhden, xhemati, i cila nuk ishte në dijenitë të kësaj, mendua me vete: "Mos vallë i ka ndodhur diçka Profetit tonë? Apo i ka zbritur ndonjë revelatë e re?" Kur përfundoi namazin, e pyetën për situatën. Ai (s.a.s.) shpreh si vijon për të pasqyruar dhembshurinë që kishte treguar: "Jo! Asnjë nga këto nuk ndodhi. Thjesht nuk doja ta shqetësoja nipin tim duke prishur lojën e tij kur ai më hipi në shpinë gjatë sexhdes. Prandaj, e zgjata sexhden time."⁷

Mëshira e Tij i përqafonte të gjithë fëmijët.

I Dërguar i Allahut (s.a.s.) nuk e tregoi dashuri dhe mëshirë

4. Ibn Sa'd, Tabakât, VI/360-362.

5. Buhari, Edeb 18; Muslim, Fedail 63.

6. Muslim, Fedailu's-Sahabe 56.

7/ Nesaî, Tatbîk 82; Buharî, Salât 106, Edeb 18; Muslim, Mesexhid 41.

vetëm për fëmijët apo nipërit e tij, por edhe për të gjithë fëmijët e sahabëve. Për shembull, Xhabir b. Semura (r.a) tregon një nga kujtimet e tij si më poshtë: "Ne e falëm namazin e drekës me të Dërguarin e Allahut. Ai u ngrit për të shkuar te familja e tij dhe unë e ndoqa atë. Pastaj, kur fëmijët që qëndronin në fillim të rrugës e pritën, edhe unë u bashkova me ta. Profeti ynë kujdesej për ta një nga një dhe u ledhatonte faqet. Kur erdhi tek unë, ai më donte dhe më ledhatonte gjithashtu. Në atë moment, unë ndjeva freski dhe një erë të këndshme në dorën e tij."⁸

Përsëri, Said Ibn-i Zejd tregon: Në fëmijërinë time, tezja ime më mori me vete kur ajo po shkonte për të vizituar të Dërguarin e Allahut (s.a.s.). Ai më përkëdhelte kokën dhe lutej për mua."⁹ Amr b. Hurajra gjithashtu tregon se nëna e tij e çoi atë në praninë e Profetit tonë, Ai i përkëdheli kokën dhe iu lut Allahut që t'i jepte mjaft ushqim.¹⁰ Abdullah b. Salam gjithashtu kur lindi djali i tij Jusufi, ai e çoi atë tek i Dërguarin e Allahut. Profeti ynë e merr fëmijën në krahët e tij dhe të dy e emërojnë atë dhe i përkëdheli kokën me dashuri.¹¹ Përsëri, Ibni Rebîa b. Harith tregon: "Babai im më dërgoi te i Dërguarin e Allahut, dhe Abasi dërgoi djalin e tij Fadl. Kur hymë në praninë e tij, ai na bëri të ulemi në gjunjë, djathtas dhe majtas. Pastaj ai na përqafoi me aq butësi dhe vendosmëri sa që kurrë nuk kishim parë dikë kaq të sinqertë që të na përqafonte."¹²

Ai që nuk tregon dhembshuri nuk është prej nesh!

Një beduin që pa të Dërguarin e Allahut duke puthur nipërit e tij e pyet Profetin tonë (s.a.s.) me habi: "A i puthni fëmijët tuaj? Unë kam dhjetë fëmijë, nuk kam puthur asnjë prej tyre deri më tani!" Profeti i Mëshirës i tha: "Ata që nuk tregojnë mëshirë nuk do të mëshirohen."¹³ Ai gjithashtu i tha një personi tjetër që dha të njëjtin reagim: "Çfarë mund të bëj nëse Zoti të ka hequr mëshirën nga zemra jote!"¹⁴ dhe i ka tërhequr vëmendjen qartazi njerëzve për mungesën e dashurisë ndaj fëmijëve. Në mënyrë që ta kuptojmë edhe më mirë këtë paralajmërim, ai tha: "Nuk është nga ne ai që i do fëmijët dhe nuk tregon mëshirë për ta"¹⁵ dhe e vendosi dashurinë e tyre në qendër të kuptimit të tij të edukimit. Duke mos u kënaqur me këtë, në një rast, "Nga mëshira janë privuar vetëm ata që janë të devjuar". Ai gjithashtu tërheq vëmendjen për fatin e keq që sjell mungesa e dhembshurisë. Në këtë kontekst, i Dërguarin e Allahut i ka lavdëruar gratë e Kurejshëve që i trajtuan fëmijët e tyre me shumë dashuri. Duke lavdëruar ato, në personin e tyre, vlerësoi të gjithë heronjtë e dhembshurisë, nënat, baballarët dhe mësuesit e tyre.

8. Muslim, Fedail 80.

9. Buharî, Davât 30.

10. Buharî, Edebu'l-Mufred fq. 221 (632).

11. Buhari, Edebu'l-Mufred fq. 134 (367).

12. Ibn Haxher, el-Metâlibu'l-âlije, II/441.

13. Muslim, Fedail 65; Tirmidhi, Birr 12.

14. Buhari, Edeb 18; Muslim, Fedail 164.

15. Ebu Davud, Edeb 66 (4943); Tirmidhi, Birr 15 (1919).

ÇËSHTJE RRETH AGJËRIMIT TË GRUAS NË

Ramazan

A është e detyruar gruaja shtatzënë dhe nëna me foshnjë në gji të agjërojë Ramazanin?

Gruaja shtatzënë dhe nëna që ushqen foshnjën me gji, nëse kanë frikë për shëndetin e tyre ose atë të fëmijës, mund të mos agjërojnë. Në këtë rast, ato nuk janë të detyruara të japin dëmshpërblim (fidje), por duhet t'i kompensojnë ditët e humbura duke agjëruar pas Ramazanit.

Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë:

"Allahu e ka lehtësuar udhëtarin duke ia shkurtuar gjysmën e namazit dhe agjërimin, si dhe e ka lehtësuar gruan shtatzënë dhe atë që ushqen fëmijën me gji duke e liruar nga agjërimi."

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ato janë të përjashtuara plotësisht nga obligimi i agjërimin. Për shkak të gjendjes së tyre të veçantë, ato mund të mos agjërojnë gjatë Ramazanit, por duhet t'i zëvendësojnë këto ditë me vonë. Kjo lehtësi u është dhënë sepse agjërimi mund të

rrezikojë shëndetin e tyre ose të foshnjës.


Nga ana tjetër, nëse një grua shtatzënë apo lehonë e ndien veten të aftë për të agjëruar pa rrezikuar shëndetin, ajo mund ta provojë dhe të përfitojë nga begatitë e Ramazanit.

A mund të shlyejë gruaja shtatzënë dhe nëna me gji ditët e paagjëruara vetëm me fidje?

Fidje quhet shuma e caktuar për të ushqyer një person të varfër dy vakte në ditë. Kjo vlerë është e barasvlershme me sadakanë e fitrit dhe përcaktohet çdo vit nga institucionet fetare.

Sipas Islamit, gruaja shtatzënë ose nëna me gji që nuk ka agjëruar në Ramazan duhet t'i kompensojë ato ditë më vonë duke agjëruar. Ajo nuk është e detyruar të japë fidje, sepse ka mundësinë ta zëvendësojë agjërimin më vonë.

Vetëm personat që nuk mund të agjërojnë më kurrë



gjatë jetës së tyre – si të sëmurët pa shpresë shërimi apo të moshuarit e pafuqishëm – lejohen ta shlyejnë agjërimin me fidje.

Kjo çështje është e sqaruar edhe në Kuranin Famëlartë:

“Agjërimi zgjat disa ditë, por nëse dikush prej jush është i sëmurë ose duke udhëtuar, le të agjërojë në ditët e tjera pas Ramazanit aq ditë sa ka prishur. Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpajm një të varfër për çdo ditë agjërimi. E nëse ndonjëri jep më shumë se kaq, kjo është edhe më mirë për të. Por të dini, se agjërimi është më i dobishëm.” (Bekare, 184)

Si duhet ta kryejë agjërimin e kefaretit gruaja me cikël menstrual?

Nëse dikush e prish me vetëdije agjërimin e një dite Ramazani duke ngrënë, pirë ose kryer marrëdhënie bashkëshortore, ai duhet të agjërojë 60 ditë rresht si dëmshpërblim (kefaret). Ky agjërim është një formë

ndëshkimi dhe pastrimi shpirtëror për thyerjen e vetëdijshme të agjërimin.

Nëse një person nuk ka mundësi të agjërojë 60 ditë rresht, ai mund ta shlyejë kefaretin duke ushqyer 60 të varfër, ose duke siguruar ushqimin e një personi të varfër për 60 ditë.

Përveç kësaj, personi duhet të agjërojë edhe një ditë shtesë për të kompensuar ditën e prishur dhe të kërkojë falje nga Allahu me pendim (teube).

Agjërimi i kefaretit duhet të bëhet pa ndërprerje. Nëse ndodh një ndërprerje e panevojshme, ai duhet të fillojë nga e para.

Por për gratë, cikli menstrual është një ndërprerje e detyrueshme dhe e pashmangshme, prandaj nuk e prish vazhdimësinë e kefaretit. Kur periodha menstruale përfundon, gruaja mund të vazhdojë agjërimin e kefaretit aty ku e ka lënë, pa e filluar nga e para.

Mata e Kadrut

ftesë e shpirtit për në lartësim

Ramazani është një mëshirë e madhe e Allahut (xh.sh.), i Cili për çdo vit e dërgon atë në mesin e besimtarëve. Mëshira, falja dhe pranimi i pendimit janë prej gjërave kryesore që Allahu (xh.sh) dhuron për robërit e Tij gjatë gjithë këtij muaji.

Ai besimtar që tregohet i zellshëm në kërkimin e kësaj mëshirë të madhe, patjetër që do të përfitojë prej këtyre puhizave të mëshirës hyjnore përgjatë gjithë Ramazanit.

Ndërsa ai besimtar i cili tregohet i zellshëm, por që e kaplon kotësia, neglizhenca dhe përtacia, nuk do të arrijë të dalë i fituar prej Ramazanit dhe nuk ka për të arritur mirësinë e madhe të faljes së gjynaheve. Pikërisht këtë njeri, Xhebraili (a.s.) do ta konsideronte "të pafat".

Profeti (a.s.) një herë duke hipur në mimber do të thoshte tre herë radhazi "amin"; kjo si shkak i tre lutjeve të Xhebrailit (a.s.), i cili në njëren lutje tha: *"I pafat është ai besimtar që e arrin Ramazanin dhe nuk del i falur prej gjynaheve"*. (Tirmidhiu)

Ramazani në tërësinë e tij është i gjithi mëshirë, falje dhe shpëtim nga zjarri i Xhehenemit, por Allahu (xh.sh) ka veçuar dhe vlerësuar disa ditë më shumë se disa ditë të tjera në këtë muaj të mëshirës, begatisë dhe faljes.

Dhjetë ditët dhe netët e fundit të Ramazanit janë pikërisht ditët dhe netët që Allahu (xh.sh.) i ka begatuar dhe vlerësuar më shumë se ditët e netët e tjera. Ky vlerësim i madh vjen si shkak i një nate të madhe që gjendet në

këto ne: Nata e Kadrit, e cila është më e vlefshme se një mijë muaj.

Allahu (xh.sh.) në Kuranin Fisnik thotë: **“Ne e zbritëm atë (Kuranin) në Naten e Kadrit. E c’të bëri ty të dish, se c’është Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj!”** (Kadr 1-3).

Një natë me vlerë më shumë se një mijë muaj, ndryshe do të thotë një natë sa një jetë. Nata e Kadrit është nata në të cilën Allahu (xh.sh.) ka zbritur Kuranin Famëlartë dhe ja ka shpallur atë Muhamedit (a.s.). Është pikërisht shpallja e Kuranit Famëlartë shkaku që nata e Kadrit mori vlerën dhe famën e madhe dhe është po ky fakt që na rikujton se cilido prej besimtarëve që arrin të zbrisë Kuranin në thellësitë e zemrës së tij dhe lidhet fort me të, njëjtë si nata e Kadrit, ai do të ketë famë dhe pozitë të lartë tek Allahu (xh.sh.).

Përtej diskutimeve teologjike në përballjen e argumentave se kur është fiks nata e Kadrit, ajo çfarë dihet me siguri është se kjo natë madhështore ndodhet në **netët teke** gjatë dhjetë netëve të fundit të Ramazanit.

Prej urtësive kryesore përse kjo natë është e fshehur, është sepse i Dërguari i Zotit (a.s.), ka dashur që të nxisë besimtarët të jenë të zellshëm në kërkimin e kësaj nate gjatë dhjetë netëve të fundit të Ramazanit. Ai do t’i përgëzonte besimtarët, dyke u thënë: “Kushdo që e gjallëron natën e Kadrit me besim dhe shpresë se shpërblimin do ta fitojë prej Zotit, atij do t’i falen gjynahet e mëparshme”. (Buhariu).

Gjallërim i kësaj nate do të thotë që besimtari të mos jetë neglizhent dhe i pavëmendshëm ndaj kësaj mirësie të madhe. Kjo është një natë që kërkon prej besimtarëve të bëhen robër të Zotit të tyre. Të tregojnë me vepër të sinqertë nevojën për Zotin duke sakrifikuar gjumin e tyre dhe rehatitë e kësaj dynjaje.

Profeti (a.s.) ishte prej atyre që nuk donte që ta humbisnin besimtarët këtë mirësi të madhe, prandaj ai, qoftë me fjalë apo me vepër, i nxiste njerëzit në adhurime të ndryshme.

Tregon Aishja (r.a.) se kur vinin dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, Muhamedi (a.s.) i gjallëronte netët me adhurim, zgjonte familjen e tij që dhe ata të kalonin netët me adhurim dhe bëhej një rob i nënshtruar i Allahut (xh.sh.). (Buhariu)

Kjo rëndësi e veçantë në kërkimin e natës së Kadrit vjen për shkak se në këtë natë Allahu (xh.sh.) cakton për njerëzit gjithçka do të ndodhë me ta përgjatë një viti të plotë. Lidhur me këtë, Allahu (xh.sh.) në Kuranin Famëlartë thotë: **“Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) zbrësin engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) për secilën cështje”.** (Kadr 4)

“Në atë (natë) zgjidhet çdo cështje në mënyrë të prerë. Urdhër i përcaktuar nga Vetë Ne.” (Duhan 4-5)

Pikërisht gjatë kësaj nate, besimtari duhet të jetë i angazhuar në maksimum për të fituar kënaqësinë e Allahut (xh.sh.). Namazi, Kurani, lutja dhe përgjërimi i sinqertë duhet të jenë tematika kryesore e kësaj nate. Besimtari duhet të lutet për t’iu lehtësuar atij brengat dhe problemet e kësaj bote, të kërkojë mirësi dhe begati për jetën e tij dhe familjen e tij, por gjithashtu më e rëndësishmja është që ai të lutet për ahiretin e tij. Të lutet për faljen e gjynaheve të tij dhe për të merituar mëshirën dhe Xhenetet e Allahut (xh.sh.).

Rëndësinë e kësaj nate na e tregon këshilla që Muhamedi (a.s.) i tha bashkëshortës së tij të nderuar Aishes (r.a.), kur ajo e pyeti të dërguarin e Allahut (xh.sh.): **“O i dërguar i Zotit! Po nëse ndodh që të qëlloj në natën e Kadrit, çfarë më sugjeron të lutem?”**

Ai iu përgjigj: lute Zotin me këtë dua:

“O Allah! Ti je Falës dhe Ai që i fshin gjynahet nga libri i veprave, e do faljen, andaj më fal mua”. (Tirmidhiu)

Nata e Kadrit është ftesa e shpirtit të besimtarit drejt forcimit të lidhjes me Kuranin Famëlartë. Nuk mund të mendohet që besimtari mysliman të mos jetë në kontakt të përditshëm me Kuranin.

Kurani famëlartë është manuali jetësor i besimtarit. Kurani i jep besimtarit udhërrëfimin që do t’i mundësojë atij lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër.

Nata e Kadrit është ftesa e shpirtit të besimtarit drejt shpresës së madhe të faljes dhe mëshirës së Allahut (xh.sh.).

Nuk i takon besimtarit të jetë pesimist në asnjë çast. Përderisa kemi shpirtin në trupin tonë, atëherë çdo ditë e re është një shpresë e re dhe një mundësi për t’ia filluar nga e para në përmirësimin e raportit me Zotin e gjithësisë.

“Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.” (Zumer 53).

Nata e kadrit është ftesa e shpirtit të besimtarit drejt jetës së amshueshme. Nuk ka diskutim që kjo botë është kalimtare dhe jeta e vërtetë është ajo pas vdekjes.

“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen. Shpërblimet do t’u plotësohen vetëm në Ditën e Kiametit; kushdo që shpëton nga zjarri i Xhehenemit dhe hyn në Xhenet, ai ka fituar (gjithçka që mund të dëshirohet). Ndërsa jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese.” (Ali Imran 185).

Nata e Kadrit na fton në shpërblime të mëdha që besimtarin e presin në botën e amshueshme. Mëshira absolute e Allahut (xh.sh.) ndaj robërve të Tij besimtarë, kuptohet nga bujaria e Tij e madhe në këtë natë, ku Ai për një natë të vetme shpërblen më shumë se një mijë muaj.

Konsiderohet si një prej begative të mëdha dhe shenjë e dashurisë së Zotit ndaj robit, nëse je prej atyre që e agjërojnë Ramazanin dhe shfryrëzon natën e Kadrit.

ZEKATI DHE DISA RREGULLA TË TIJ

Hyrje

Zekati është njëra prej pesë shtyllave mbi të cilat është ngritur feja Islame. Ai është ibadet - adhurim që i kushtohet Allahut (xh.sh.) dhe njëkohësisht është institucion mjaft i rëndësishëm për myslimanët. Përmes kryerjes së këtij obligimi, myslimani e pas-tron jo vetëm shpirtin e tij, por edhe pasurinë që ia ka dhuruar dhe ia ka mundësuar Allahu i Gjithëmëshirshëm. Njeriu, i cili e zbaton këtë detyrim, e fiton kënaqësinë e Allahut.

Në Kuran, në shumë vende, krahas namazit, Allahu e ka për-me-ndur edhe zekatin, që në fakt vetëm sa e vërteton vlerën dhe rëndësinë që e ka ky institucion. Allahu i Gjithëmëshirshëm, në një ajet të Kuranit, urdhëron:

خُذْ مِنْ أَمْوَالِهِمْ صَدَقَةً تُطَهِّرُهُمْ وَتُزَكِّيهِمْ بِهَا

"Merre zekatin prej pasurisë së tyre (të besimtarëve që e kanë nisabin), në mënyrë që me të t'i pastrosh ata dhe t'ua shtosh (begatitë)..."¹.

Edhe në traditën e Pejgamberit (a.s.) zekati zë vend meritore. Pejgamberi (a.s.) kur e ka dërguar Muadh bin Xhebelin në Jemen, tregohet t'i ketë thënë: *"...Mësoji ata se Allahu ua ka bërë obligim zekatin për pasurinë e tyre; të merret nga të pasurit e tyre e t'u jepet të varfërve të tyre"*.

Me një rast tjetër, Pejgamberi (a.s.) urdhëron: *"Respektojeni Allahun, falini pesë kohët e namazit, agjërojeni muajin e Ra-maza-nit, jepeni zekatin e pasurisë suaj dhe respektojini prijësit tuaj, do të hyni në Xhenetin e Zotit tuaj"*.

Bazuar në ajetet kuranore dhe hadithet e Pejgamberit (a.s.), të gjithë dijetarët islamë kanë konfirmuar unanimisht se dhënia e zekatit është farz - detyrim - për myslimanë e myslimane, të cilët posedojnë pasuri, sasia e së cilës është e përcaktuar me norma të Sheriatit (nisabi).

Sipas të dhënave autentike, vërehet se zekati është përmendur edhe para Hixhretit të Pejgamberit (a.s.), pra që në fillimet e misionit profetik, sa ai jetonte dhe vepronte në Mekë, por, për shkak të gjendjes së vështirë në të cilën ndodheshin myslimanët, ishte gati e pamundur që atë ta jetësonin. Fjalët e Xhafer ibni Ebi Talibit që ia kishte thënë sundimtarit të Etiopisë, Nexhashiut, kur pati emigruar atje, se Pejgamberi kishte poro-situr që, krahas faljes së namazit, ata ta jepnin edhe zekatin e pasurisë së tyre, tregojnë se mendësia e zekatit në mos si detyrim, së paku si vepër e mirë dhe e admiruar, pati filluar të përhapej që nga vitet kur Pejgamberi ako-ma jetonte në Mekë.

Prandaj, në vitin e dytë të Hixhretit në Medinë², tash në

kush-te dhe rrethana më të mira se më parë, ky detyrim do të përsëritej edhe një herë, e më pastaj edhe shumë herë të tjera. Madje, një përsëritje e tillë veç sa e vërteton rëndësinë që ka ky institucion dhe në vazhdimësi ua rikujton myslimanëve detyrueshmërinë e praktikimit të tij.

Ç'është e vërteta, tek arabët, një lloj dhënie e pasurisë ka ekzistuar edhe para fillimit të zbritjes së Kuranit, por kjo bëhej nga të varfrit të cilët detyroheshin që të jepnin një sasi të pasurisë së tyre në dobi të të pasurve! Ndërkaq, me institucionalizimin e zekatit, që nga viti i dytë i hixhretit, dhënia e pasurisë vazhdon edhe më tutje, por tash në drejtim tjetër, gjegjësisht të pasurit duhet të jepnin në dobi të të varfërve, të atyre që nuk kanë pasuri të mjaftueshme për jetë.

Kuptimi gjuhësor dhe terminologjik i zekatit

Nocioni Zekat në kuptimin gjuhësor e ka kuptimin: pastrim, rritje, shtim, shumëfishim, begati, bereqet...

Kurse, në kuptimin terminologjik të Sheriatit, zekati e nënkupton veprimin e dhënies së një pasurie në sasi të caktuar, nga persona të caktuar, individëve ose instancave të caktuara me nijet adhurimi.

Nga kjo kuptohet se, nëse namazi dhe agjërimi janë ibadete që kryhen me trup, zekati është një ibadet që ka të bëjë me pasurinë, synim i të cilit është ngritja dhe mirëqenia e nivelit shoqëror. Pra-ndaj, është me shumë rëndësi të kuptohet drejt se çështja e zekatit nuk është si puna e një shoqate humanitare, ose e një soli-daritetit i rastit, siç shfaqet në disa mjedise shoqërore, por fjala është për një postulat islam, mbi të cilin është ngritur kjo fe, siku-ndër janë edhe namazi, agjërimi dhe haxhi. Pra, nuk është fja-la për një dhënie ose kontribut të thjeshtë, por, para së gjithash, për një ibadet-adhurim, ibadet të kategorisë së namazit, agjërimit e haxhit.

Si institucion që është, zekati e ka zanafillën dukshëm më herët se koha e Pejgamberit (a.s.). Kurani tregon se si profetët Is'haku, Jakubi, Ismaili e Shuajbi³ ishin ngarkuar, krahas faljes së namazit, edhe të jepnin zekat. Madje, edhe të bijtë e Izraelit (beni Israi-lët) patën dhënë fjalën për detyrime si këto.⁴ Për më tepër, Kurani e përmend se si edhe vetë Isai pati thënë qysh në djep se Zoti e kish-te urdhëruar të falte namaz dhe të jepte zekat sa të jetë gjallë⁵. Ajo që në fenë islame quhet zekat, në hebraizëm dhe krishterim, si dhënie e një pjese të

se zekati aq shumë herë është përsëritur në Kuran, si-domos së bashku me namazin. Më gjerësisht: Dr. Nerkez Smailagić, "Leksikon Isla-ma", bot. Svetlost- Sarajevo, 1990, fq. 679 e tutje.

3. Në Kuran: Enbija: 73, Merjem: 55, Bejjine: 5, Hud: 87.

4. Shih në Kuran: El-Bekare: 83, El-Maideh: 72.

5. Në Kuran: Merjem 30-33.

1. Kuran, Et-Tevbe: 103.

2. Koha e bërjes farz - detyrim për besimtarët është nga viti 2-9 i hixhretit dhe kjo është më e saktë. Kjo edhe për faktin

pasurisë, mund të ketë pasur dallime edhe në formë edhe në përmbajtje, por me rëndësi është se si veprim i ngjashëm ka ekzistuar edhe tek ata.

Gjatë kohës së Pejgamberit (a.s.) dhe kalifëve të drejtë pas tij, organizimi i mbledhjes së zekatit ishte bërë në mënyrë meritore. Ata patën ngarkuar me detyrën e organizimit të dhënies dhe të mbledhjes së zekatit persona me rëndësi duke filluar nga sahabët. Pejgamberi pati ngarkuar personalisht me këtë detyrë sahabët, si: Muadh Ibni Xhebelin, hazreti Ymerin, Ubejje Ibni Ka'bin, Zejd Ibni Harithen, Ebu Rafiun, Kajs Ibni Sa'd ibni Ubadeten, Ibni Meslemen, Ubadete Ibnu Thabitin dhe Ibnu Utejbijen. Ndërkaq, gjatë kohës së hulefai-rashidinëve personat që kanë qenë të ngarkuar me detyrën e nëpunësve të zekatit kanë qenë: Enes Ibni Maliku, Abdullah Ibni Sa'di, Ebu Ubejde Ibni Xherrahi dhe Imran Ibni Husajni. Puna e mirëfilltë dhe organizimi i sinqertë me zekatin kishte rezultuar asokohe me mirëqenie të gjithëmbarshme, aq sa ishin vërtetuar fjalët e Pejgamberit (a.s.), i cili kishte paralajmëruar se *"...do të vinte një ditë kur dikush do të sillej me sadaka floriri në dorë dhe nuk do të gjente njeri për t'ia dhënë"* - sikundër ishte koha e Ymer ibni Abdyl-Azizit, e cila e dëshmoi konstatimin e mësipërm.

Kushtet për dhënien e zekatit

Për ta pasur zekatin detyrim duhet të plotësohen disa kushte. Disa prej këtyre kushteve kanë të bëjnë me mallin-pasurinë e disa të tjera kanë të bëjnë me personin i cili e jep atë.

-Së pari do të ndalemi te kushtet e mallit, sepse për ta dhënë ze-katin e një malli, i njëjti duhet t'i plotësojë disa kushte dhe ve-tëm më pastaj lind detyrimi i dhënies së zekatit për atë mall:

-**Pronësia.** Qëllimi me këtë rast është që personi të ketë të drejtën e pronësisë së plotë mbi atë mall, pra të jetë pronar i vërtetë domethënë që të ketë të drejtën për ta përdorur atë mall si të dojë.

-**Shtueshmëria.** Domethënë që ai mall duhet të jetë i shtueshëm, të shtohet e të sjellë të ardhura e fitime, gjë që realizohet me anë të lindjes, riprodhimit, tregtisë, shtimit etj.

-Nisabi. Është minimumi i sasisë së domosdoshme që duhet të ketë malli për të cilin duhet të jepet zekat. Kjo është e përcaktuar në Sheriat për çdo mall. Detajet e nisabit do t'i japim për secilin mall veç e veç.

-**Teprica** mbi nevojat bazë. Pra, malli për të cilin duhet dhënë zekat, duhet të përbëjë tepricë mbi nevojat bazë të personit dhe të pjesëtarëve të familjes që ka nën kujdestari, si ushqimi, veshmbathja dhe strehimi. Nga zekati përjashtohen edhe mallrat si veglat e punës (profesionit), pajisjet e shtëpisë dhe kafshët, ose mjetet e transportit.

-**Teprica mbi borxhet.** Për t'u ngarkuar me zekat, personit i zbriten nga malli ose pasuria që ka, borxhet që janë hak i njeriut e që duhet të paguajë, e pastaj nëse mbetja e arrin masën e nisabit, zekati për të bëhet farz. Në të kundërtën, nëse pas zbritjes së borxheve, pasuria e mbetur nuk e arrin nisabin, ai nuk detyrohet me zekat.

-Pasuria të ketë qenë në pronësi (posedim) **të plotë për një**

vit (*haul* - حول) sipas kalendarit hënor e jo diellor. Sipas juris-të-ve hanefinj nisabi është kusht që të jetë i kompletuar në fillim dhe në fund të vitit, pavarësisht se gjatë vitit ka pasur rënie të saj. Kjo vlen për mallrat e tregtisë, kafshët, arin e argjendin, pa-ra-të në monedhë e kartëmonedhë. Kurse për prodhimet e tokës, mineralet dhe thesaret, detyrimi i dhënies së zekatit për to lind sapo të krijohet pronësia mbi to. Hazreti Aishja ka thënë:

عن عائشة قالت: سمعتُ رسولَ الله (ص) يقولُ: "لَا زَكَاةَ فِي مَالٍ حَتَّى يَحُولَ عَلَيْهِ الْحَوْلُ".

*"E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë: 'Nuk i nënshtrohet zekatit pasuria që nuk e mbush vitin'."*⁶

-B. Kushtet që kanë të bëjnë me personin. Për t'u bërë zekati detyrim - farz për personin, ky i fundit duhet t'i plotësojë këto kushte:

-Pronari i pasurisë **të jetë mysliman**. Sepse jomyslimanët, të cilët jetojnë në shtetin islam obligohen me pagesën e xhizjes, e jo edhe të zekatit, sado që të kenë pasuri.

-Personi duhet të jetë i **lirë**, sepse skllëverit nuk janë të obliguar me këtë detyrim.

-Personi duhet ta ketë plotësuar **moshën e pubertetit**, sepse, sipas Sheriatit, kjo është moshë kur fillon përgjegjësia ligjore-fetare. Kjo nënkupton edhe pjekurinë seksuale dhe atë mendore, prandaj, ashtu si në adhurimet e tjera, si namazi, agjërimi dhe haxhi, personi bëhet përgjegjës kur të ketë mbushur moshën e pubertetit dhe të ketë zhvillim mendor normal; pra në këto kondita obligohet edhe me zekat.

Nga kushtet e sipërpërmendura kuptohet se jomyslimani nuk është i obliguar me dhënien e zekatit sikurse edhe ai që është i privuar nga liria. Gjithashtu, edhe fëmija ose i riu i mitur, i cili nuk e ka arritur moshën e pubertetit, nuk obligohet me zekat, ndonëse pasuria e tij tejkalon nisabin, kështu që zekatin për pasurinë e tij duhet ta japë kujdestari (personi që përkujdeset ligjërisht për atë fëmijë). Kjo për faktin se zekati është ibadet-adhurim, kurse dihet mirëfilli se i mituri nuk është i ngarkuar me të. E njëjta dispozitë vlen edhe për të çmendurin dhe atë që nuk ka zhvillim mendor.

Nijeti - qëllimi me rastin e zbatimit të zekatit

Në hadithin e mirënjohur, në të cilin përmenden shtyllat e fesë islame, Pejgamberi (a.s.) e ka përmendur edhe zekatin. Prandaj, ai që e jep do të shpërblehet, kurse ai që nuk e jep do të ndëshkohet. Ai që e mohon zekatin si detyrim-farz, ai del nga feja, ndërkaq ai që nuk e mohon por nuk e jep, nuk del nga feja, por është mëkatar i madh. Pas namazit, zekati është adhurimi-farzi më me vlerë. E si mos të jetë kur ai përmendet, krahas namazit, në 32 ajete kuranore. Prandaj, duke e ditur se çdo adhurim e ka si kusht edhe nijetin, atëherë me rastin e dhënies së zekatit duhet bërë nijet ashtu që zekati të bëhet adhurim i vlefshëm. Në të kundërtën, nëse dikush e jep zekatin pa e bërë nijet, ai zekat nuk është i vlefshëm. Me këtë rast, nijeti bëhet me zemër, por në qoftë se atë e dëshmon edhe me gojë, kjo natyrisht është shumë më e vlefshme.

6. Transmeton Ibni Maxheh.

Profesioni i Sahabeve dhe veçoritë e tyre

Të marrësh pjesë në atmosferën e Resulullahut (a.s.) dhe të ngjyrosesh me bojën e Tij, t'i dalësh për zot Islamit në momentet më të vështira ku dhe duhet marrë parasyshë vdekja, duke mos gënjyer asnjëherë qoftë edhe për shaka dhe në këtë mënyrë të arrish në gradën e njerëzve më të mirë përveç profetëve, do të thotë *"profesion i sahabeve"*.

Nën udhëheqjen e Kuranit dhe Sunetit

Veçoria më kryesore e profesionit të sahabeve, rrugë e cila është ndjekur edhe nga njerëzit e urtë, trashëgimtarët e Profetit, është mundimi i tyre për t'i vlerësuar problemet sipas Nassit (pa patur nevojë për komentime, por sipas ajeteve dhe haditheve). Çdo çështje e sahabeve të nderuar fokusohej tek të kuptuarit të vullnetit hyjnor, për të vepruar në përputhje me kënaqësinë e Zotit dhe për ta fituar atë kënaqësi. Për çdo çështje me të cilën përballeshin, fillimisht mendonin se "Vallë çfarë kërkon Allahu (xh.xh.) nga ne?".

Ata kanë treguar një mund dhe përpjekje të paimagjinueshme dhe të pakrahasueshme me asnjë brez tjetër ndër shekuj për të mësuar kënaqësinë e Allahut nëpërmjet fjalës hyjnore, pra Kuranit Famëlartë.

Një tjetër veçori kryesore e këtij profesioni është edhe serioziteti i treguar për të ndjekur me përpikmëri traditën profetike. Pra serioziteti për të ndjekur fjalët, veprat dhe sjelljet e të dërguarit të Allahut (a.s.). Ashtu si çdokush që

dëshiron ti ngjajë atij që admiron, po ashtu edhe sahabet e nderuar të cilët ishin shumë të lidhur shpirtërisht me Resulullahun (a.s.) dëshironin dhe mundoheshin ti ngjasonin Atij jo vetëm në adhurime por në çdo veprim apo sjellje. Të mundohesh ti ngjasosh Resulullahut (a.s.) në të gjitha veprat dhe sjelljet tona normale në jetën e përditshme na bën të fitojmë sevape. Njeriu fiton sevape edhe nëse në veprat dhe sjelljet me të thjeshta dhe të zakonshme në jetën e tij të përditshme, si mënyra e të ngrënit, të pirit, të fjeturit, të folurit, të qëndruarit ulur etj., mundohet që t'i ngjasojë të dërguarit të Allahut (a.s.).

Ja pra, sahabet e nderuar i konsideronin si pjesë të adhurimit edhe veprimet apo sjelljet më të zakonshme të Resulullahut (a.s.) dhe e kanë ndjekur hap pas hapi më një dëshirë të paarritshme nga askush tjetër.

Kerameti (mrekullia) i vërtetë i Sahabeve

Një ndër veçoritë më kryesore të profesionit të sahabeve është mospasja e dëshirës për të kërkuar keramet (mrekulli) nga Zoti. Të gjithë sahabet janë "Velij (njerëz të dashur të Allahut (xh.xh.))". Velajeti (të qenit njeri i dashur i Allahut(xh.xh.)) i tyre quhet "velajeti kubra" dhe vjen nga "veraseti nubuvvet"(trashëgimia profetike pra të qenit trashëgimtarë të Resulullahut (a.s.)). Sahabet e nderuar nuk kanë patur nevojë të kalojnë nëpër rrugëtimin e Velijve (njerëzve të dashur të Allahut (xh.xh.)) të tjerë



sepse kanë arritur të vërtetën drejtpërdrejt me mirësi të Allahut (xh.xh.). Prandaj dhe rruga e tyre për tek e vërteta, pra për tek Allahu (xh.xh.) është shumë e shkurtër dhe nuk ka nevojë për keramet (mrekulli), dhe po të shikohet jeta e tyre, do të vërejmë shumë pak keramete (mrekulli).

Por vallë a kanë patur sahabet keramete (mrekulli), frymëzim para se të ndodhë diçka? Patjetër që kanë patur, por ata anjëherë nuk ja kanë kërkuar Zotit një gjë të tillë. Madje e kanë konsideruar atë si sprovë nga Zoti dhe janë munduar ta fshehin edhe nëse u ndodhte. Por ka patur dhe raste të tilla që nuk kanë mundur t'i shpëtojnë shikimit të njerëzve edhe pse janë treguar të kujdesshëm në fshehjen e këtyre situatave.

Për shembull: Ndërsa Omeri (r.a.) po predikonte në hutbe, i shfaqet ushtria në një gjendje të vështirë që kishte dërguar në Iran dhe menjëherë i flet komandantit "Sarije shiko nga mali"; edhe pse shumë kilometra larg, komandanti Sarije e dëgjon zërin e Omerit (a.s.), shikon kurthin e armikut nga mali, menjëherë merr masa dhe e fiton betejën.

Ka patur prej atyre sahabeve të nderuar të cilëve u pranohej menjëherë çdo lutje që ata bënin. Ashtu si ka thënë dhe i dërguari i Allahut (a.s.): "Ka prej atyre njerëzve me pamje mjerane që po të betohen në Emër të Allahut për një çështje, Ai nuk i nxjerr ata gënjeshtarë. (E pranon betimin e tyre dhe e realizon.)" Bera bin Malik (a.s.) ishte

njeri prej tyre. Madje ka transmetime se kur myslimanët ishin në gjendje të vështirë në luftë, sahabet shkolin pranë Bera bin Malik'ut dhe i thonin: "Betohu se do ta fitojmë luftën sepse Allahu ty nuk të nxjerr gënjeshtar!"

Një tjetër sahabë të cilit i pranohej lutja menjëherë ishte dhe Sad ibn Ebi Vakkasi (r.a.). Një ditë, ndërsa Aliu, Zybejr ibn Avvami dhe Talha ibn Ubejdullahu (r.anhum) po ecnin nëpër rrugët e Kuffes në Irak, Sadi dëgjon një njeri i cili po i ofendonte ata rëndë. E kritikon dhe e porositi disa herë që të flasë fjalë të mira ose të heshtë. Por ai njeri nuk zuri mend dhe vazhdoi t'i ofendonte 3 sahabet e nderuar deri sa Sad ibn Ebi Vakkasi ngriti duart nga qielli dhe iu lut Zotit në këtë mënyrë: "O Allahu im, jepi atë çka meriton këtij njeriu në mënyrë që dhe njerëzit e tjerë të nxjerrin mësim prej tij."

Pa kaluar shumë kohë, një deve e shashtisur që nuk u kuptua nga erdhi, vraponte me shpejtësi drejt turmës së njerëzve dhe sikur të kërkonte atë njeri nga mezi i turmës, e përplas dhe e shkel me këmbë deri sa përsosni në fjalë ndërron jetë në sy të turmës së njerëzve.

Ja pra, ka patur edhe prej atyre sahabeve të cilët edhe pse nuk i kërkonin Zotit diçka të tillë, janë përballur me këto situata. Sahabet mundoheshin që me çdo veprim të fitonin kënaqësinë e Zotit të tyre, të jetonin sipas parimeve hyjnore dhe të thelloheshin në botën e tyre shpirtërore. Ndërkohë që Zoti i begatonte me keramete të tilla.

TRUPI DHE SHPIRTI

Këndi mistik

Njeriu përbëhet nga trupi dhe shpirti. Trupin mund ta krahasojmë me një pallat, brenda të cilit është Fanari, zemra dhe brenda saj është drita hyjnore, shpirti. Trupi e shpirti janë si një shtëpi që ka pronarin e saj, kështu që plotësojnë njëri-tjetrin. Pa shpirtin, pronarin, shtëpia është e pavlefshme. Shpirti punon brenda trupit, kështu që pa të nuk do të kishte vend për të jetuar, nuk do të kishte mundësi t'i shfaqte cilësitë e tij mbi tokë. Shpirti brenda trupit dhe bashkë me trupin. Kur pronari është aty edhe trupi është në kushte të përsosura, atëherë mund të shfaqet mesazhi i shpirtit dhe mund të plotësohet.

Ne duhet të dimë se çfarë na ofron trupi dhe çfarë shpirti. Shpirti na ofron të kuptuarit, ndërsa trupi shfaqjen. Për këtë shfaqje shpirti ka nevojë për trupin e, për të kuptuar, trupi ka nevojë për shpirtin. Trupi ofron kapacitetin e tij në shërbim, shpirti ofron kapacitetin e tij në meditacion, kështu që të dy punojnë në mënyrë të përsosur.

Toka është fusha e të kuptuarit dhe në të njëjtën kohë e shfaqjes. Të kuptuarit e Allahut mund të bëhet edhe këtu në tokë në njëfarë mënyre që ia lejon mjedisi dhe vazhdon të përsoset kjo njohje për krejt ekzistencën e Tij. Ata që duan të njohin Zotin duhet ta pranojnë trupin e njeriut nëpërmjet të cilit shpirti mund të shfaqë hyjninë e Tij, që është paqja e pafund. Drita e përjetshme, bekim i pambarim. Trupi ka nevojë për shpirtin dhe ky ka nevojë për trupin. Për të njohur të vërtetën më thellë trupi ka nevojë për shpirtin dhe anasjelltas, për shfaqjen e kësaj të vërtete shpirti ka nevojë për trupin.

Nëse shpirti nuk përpiqet ta frymëzojë e ta ndriçojë trupin, ky i fundit mbetet i verbër, injorant, i errët dhe i papastër. Dhe për bashkëpunimin me trupin shpirti do të mbetet i pashfaqur dhe i pashfrytëzuar. Shpirti kërkon të kuptohet e vërteta dhe të bëhet shfaqja e saj nëpërmjet trupit, por trupi nuk i përgjigjet atij. Trupi mund të jetë fizikisht i fortë, por, nëse aspiron për dritën e

brendshme dhe të vërtetën që mund t'ia ofrojë shpirti, atëherë ky nuk mund ta përmbushë atë.

Trupi e shpirti këtu nuk janë të pandashëm, por plotësojnë njëri-tjetrin. Shpirti mund të ekzistojë pa trupin, por nuk mund ta shfaqë veten, ndërsa trupi nuk mund të ekzistojë më tepër se pak orë pa shpirtin. Për të përmbushur detyrat e tyre të përbashkëta, trupi e shpirti kanë nevojë për njëri-tjetrin.

Një trup që nuk inspirohet nga shpirti, mbetet si i vdekur, pse vetë natyra e tillë është e tillë. Po kështu edhe mendja dyshon për çdo gjë e për çdo njeri. Nëse e pranojmë jetën shpirtërore, trupi duhet të aktivizohet. Edhe nëse në fillim nuk mund të drejtohet si duhet, së paku vihet në lëvizje. Ai megjithëse nuk është në gjumë 24 orë, vetëdija e tij është në gjumë. Një trup që aspiron, është energjik.

Jeta duhet të bëhet dinamike e jo agresive. Ajo duhet të përpiqet që të inspirojë edhe të tjerët, në vend që të përpiqet të kontrollojë e t'i shkatërrojë ata. Ajo duhet t'u thotë atyre "mos humbni kohën tuaj të çmuar, ngrihuni e bëni diçka për vete e për njerëzimin".

Një mendje e qartë dhe e pastër, një mendje që është e ndriçuar prej dritës së shpirtit, do të shtrihet gjithandej. Ajo thotë: "Unë nuk lidhem vetëm në një gjë, unë nuk ushqej më dyshime, nuk nënvlerësoj njeri, përkundrazi, do të shtrihem e të zgjeroj vetëdijen time e të ndihmoj të tjerët që të bëjnë të njëjtën gjë".

Nëse do ta ushtrojmë jetën shpirtërore, do të aktivizojmë trupin, mendjen e jetën. Nëse nuk pranojmë jetën shpirtërore, do të mjaftonte të kishim të bënim me një trup që është kredhur në gjumë e që kthehet në një forcë agresive e destruktive dhe me një aftësi që është e kufizuar e që ushqen dyshime dhe në fund hedh poshtë botën që e rrethon.

Prandaj, të mos mjaftohemi vetëm me njëren dhuratë, trupin, që na ka dhënë Zoti, t'i vëmë në dispozicion fakultetet e tjera të panumërta, nga të cilat shpirti është mbi të gjitha

MËSIMET MORALE DHE PARANDALIMI I KANCERIT



Është vlerësuar se rreth 80-90% e të gjitha rasteve të kancerit janë të lidhura me ndikimet mjedisore dhe të stilit të jetesës. Shumë qendra kërkimore të kancerit vlerësojnë se 80-90% e kancereve të njeriut janë të parandalueshëm. Përveç kimikateve dhe infeksioneve (virale dhe parazitare), faktorët e jashtëm përfshijnë dietën ndërmjet një sërë faktorëve të tjerë tërësisht ose pjesërisht të përcaktuara nga sjellja personale. Edhe pse faktorët gjenetikë dhe mosha ndikojnë në fillimin e kancerit, përfundimi është se shumë kancere të njeriut janë të shmangshëm. Një numër i madh prej tyre janë të lidhur me pirjen e duhanit, konsumimin e alkoolit, homoseksualitetin, imoralitetin dhe ekspozimin e tepruar ndaj rrezeve të diellit, të gjitha praktika jo të miratuara në shoqëritë tradicionalisht fetare.

Dr. John Hill, një mjek në Londër, raportoi një rritje të kancerit të buzës në duhanpirësit me llullë që në vitin 1761. Më vonë, shumë kimikate u provuan të ishin kancerogjene dhe kështu shumë të tillë filluan të shmangen ose të përdoren duke pasur shumë kujdes. Rrezatimi jonizues është ende një rrezik i rëndësishëm, por i parandalueshëm nëse merren masat e duhura.

Duhani dhe kanceret

Në shumë vende kanceri është shkaku i dytë më i rëndësishëm i vdekjeve. Në ShBA dhe në shumë vende të zhvilluara, ai është përgjegjës për 20% të të gjitha vdekjeve. Rreth 6 milionë raste të reja të kancerit zbulohen çdo vit në të gjithë botën, nga të cilat rreth një milion janë të shkaktuara nga pirja e duhanit. Numri i të vdekurve për shkak të sëmundjeve malinje në ShBA arrin në 400-450 000 çdo vit, nga të cilët 100 000 janë për shkak të kancerit të mushkërive, 85-90% e tyre për shkak të pirjes së duhanit. Në të vërtetë, duhani është faktori më i rëndësishëm i rrezikut të kancerit në përgjithësi, përgjegjës për 30-40% të të gjithë kancereve. Asnjë agjent tjetër i vetëm nuk është shqyrtuar në mënyrë më të detajuar, as përcaktuar në mënyrë aq të saktë si agjent shkaktar i kancerit, sesa pirja e duhanit. Le të shikojmë disa nga faktet.

Rreziku i duhanpirësve për zhvillimin e kancerit të mushkërive rritet me numrin e cigareve të pira, kohëzgjatjen e pirjes, kohën e fillimit dhe llojin e pirjes së duhanit. Përafërsisht një e gjashta e atyre që pijnë dy paketa cigaresh në ditë do të zhvillojnë kancer të mushkërive me siguri. Rreziku për të ata që pijnë 40 cigare në ditë është 25

herë më i madh se te jo-duhanpirësit. Pirja e duhanit shkakton të gjitha llojet kryesore të kancerit të mushkërive, duke përfshirë tumorin skuamoqelizor, adenokarcinomën, karcinomën me qeliza të vogla dhe të mëdha. Kanceri i mushkërive ishte një formë e rrallë e kancerit në fillim të këtij shekulli, madje edhe në vendet e zhvilluara. Meqë pirja e duhanit u rrit në mënyrë drastike pas Luftës së Parë Botërore, te burrat dhe te gratë pas Luftës së Dytë Botërore, incidenca e kancerit të mushkërive erdhi në rritje të pandërprerë deri në vitet '70, kur filloi të bjerë te burrat dhe një dekadë më vonë te gratë. Megjithatë, kanceri i mushkërive është ende i pari kancer vrasës në shumë vende të zhvilluara dhe në zhvillim. Në Hong Kong, vlerat për gratë tani janë më të lartat në botë. Vlerat e kancerit të mushkërive në meshkujt kinezë (p.sh. 50.2 për 100.000 banorë në Shanghai) janë më të larta se sa të Amerikës së Veriut dhe të Evropës. Ai është shkaku kryesor i vdekjeve nga kanceri te meshkujt në Bullgari, Kubë, Çekosllovakia, Egjipt, Greqi, Hong Kong, Hungari, Izrael, Filipine, Poloni, Rumani, Singapor, Tajlandë, Uruguai dhe Zimbabve. Rreziku është më i madh në mesin e atyre që e kanë filluar duhanin në moshë të re dhe ata që pinë cigare me sasi të larta të katranit.

Kanceri i laringut është kanceri i dytë i shkaktuar nga pirja e duhanit, por numri i përgjithshëm i rasteve është më i vogël se kanceri i mushkërive dhe mbijetesja është shumë më e mirë.

Duhanpirësit kanë pesë herë më shumë gjasa për të zhvilluar kancerin e gojës dhe ezofagut se jo-duhanpirësit. Ekziston një lidhje midis alkoolit dhe duhanit në shkaktimin e kancerit të ezofagut, laringut dhe kavitetit oral.

Pirja e duhanit është gjithashtu një faktor i rëndësishëm i kancerit të fshikëzës urinare, veshkave dhe pankreasit. Shoqërimi i kancerit të stomakut dhe pirjes së duhanit gjithashtu është vënë qartë në dukje. Pirja e duhanit është implikuar edhe në kanceret që prekin gjoksin, mëlçinë, qafën e mitrës, uterusin dhe shumë organe të tjera. Ai gjithashtu është i përfshirë në kancerin e lindur te fëmijët, si rezultat i ekspozimit të nënës ndaj duhanit para lindjes. Edhe pirja pasive e duhanit është implikuar në shkaktimin e shumë rasteve të kancerit.

Karcinogjenet në tymin e duhanit

Tymi i duhanit është një aerosol i përbërë nga rreth 2000 substanca të ndryshme, 50 nga të cilat janë provuar tashmë të jenë kancerogjene për njeriun, p.sh. pirinat benza,

benza anthraceni, benzo floaranteni, benzeni dhe derivatet e tjera benzile, kadmiumi, kriseni, metilkriseni, metil fiouranteni dhe nitrozo komponimet.

Tymi i cigareve përmban edhe sasi të konsiderueshme të substancave radioaktive si p.sh. torium Th228, polonium-210 dhe radium-Rd226. Këto komponime depozitohen në mushkëri, ku vazhdimisht rrezatojnë qelizat aty pranë dhe kështu favorizojnë ndryshimet malinje. Edhe urina e duhanpirësve përmban substanca mutagjene për bakteret dhe substanca që shkaktojnë ndryshime në kromozomet e qelizave të njeriut in vitro.

Tymi i duhanpirësve pasivë përmban përqendrim 50-fish më të madh sesa nitrosaminat e tymit kryesor. Në një orë frymëmarrje në një dhomë të mbushur me tym, një jo-duhanpirës mund të thithë një sasi nitrosaminash ekuivalente me shumën e thithur sikur të kishte pirë 15 cigare.

Lënia e duhanit

Rreziku i kancerit pas lënies së duhanit zvogëlohet ndjeshëm. Te duhanpirësit e lehtë rreziku ulet 10-15 vjet pas ndërprerjes së duhanit, ndërsa te duhanpirësit e rëndë ka një mbetje dy deri në trefish edhe pas ndërprerjes. Mekanizmi i karcinogjenezës së mushkërive dhe ndërprerjes së duhanit është mjaft i studiuar dhe tashmë i sigurt.

Gratë dhe pirja e duhanit

Meqenëse gratë e filluan pirjen e duhanit shumë më pas burrave, ka një vonesë në kohë në incidencën e kancerit të mushkërive tek to. Incidenca e kancerit të mushkërive ka rënë tashmë për burrat në vendet në zhvilluara, ndërsa ishte ende në rritje për gratë në fillim të viteve '80. Në vitin 1984, 32% e grave pinin duhan në Britani krahasuar me 36% të meshkujve. Në vitin 1961, shifrat kanë qenë 60% e meshkujve dhe 40% e femrave. Ndërsa në vitin 1950 gruaja duhanpirëse tymoste gjysmën e cigareve krahasuar me meshkujt, në vitet '80 shifrat përkatëse ishin 14 dhe 16 cigare.

Gjatë dekadës së dytë të fushatës anti-duhan në Britani, pirja e duhanit filloi të bjerë në mesin e femrave gjithashtu, ngadalë në fillim, por u përshpejtua më pas. Trende të ngjashme janë gjetur në të gjitha vendet e zhvilluara, p.sh. në Australi, pirja e duhanit në mesin e grave të reja dhe të moshës së mesme ishte në rritje në fillim të viteve '80. Përqindja e duhanpirësve meshkuj ishte në rënie në 19 nga të 22 vendet e zhvilluara dhe për gratë në rritje ose e

qëndrueshme në 11 vende. Në Austri, Gjermani, Itali, Japoni, Rusi, pirja e duhanit në mesin e grave ishte ende në rritje në fillim të viteve '80.

Ne mund të vëmë re se kanceri i mushkërive ka tejkaluar tashmë kancerin e gjirit në numrin e viktimave që shkakton. Gratë duhanpirëse pasive nga burrat e tyre dhe gratë jo-duhanpirëse që punojnë në mjedise të pirjes së duhanit janë të prekura gjithashtu nga kanceri i mushkërive.

Trendet në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim

Fushatat anti-duhan kanë filluar në vendet e zhvilluara në tri dekadat e fundit dhe arritjet janë të jashtëzakonshme. Në Britani, 60% e meshkujve ishin duhanpirës në vitin 1961 (vit para se të publikohej raporti i parë i Kolegjit Mbretëror të Mjekëve rreth pirjes së duhanit). Më 1971 kjo shifër kishte rënë në 47%, më 1984 në 36% dhe në vitin 1992 më pak se 25% e meshkujve të rritur ishin duhanpirës. Siç është vënë në dukje tashmë, një trend i ngjashëm mes grave duhanpirëse ishte i dukshëm me një vonesë 10-vjeçare. Rënia e konsumit të duhanit në vendet e tjera evropiane dhe në ShBA ka qenë e konsiderueshme. Nga mesi i viteve '80 shitjet kishin rënë në mënyrë mbresëlënëse me 20%, me një rënie vjetore 5-10%.

Si është e mundur që kompanitë e duhanit kanë shitur 10 miliardë cigare që ata prodhojnë në ditë? Duke promovuar shitjet në vendet e varfra të botës së tretë, të cilat tashmë vuajnë nga shumë rreziqe të tjera serioze shëndetësore. Konsumi i duhanit në vendet e botës së tretë ka parë një rritje të tmerrshme. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka raportuar se sëmundjet që lidhen me duhanpirjen janë në rritje në vendet në zhvillim.

Gjatë tri dekadave të fundit në Senegal përqindja e njerëzve që pinë duhan në zonat urbane ka arritur në 80%, në Bangladesh 70%, në Laos 72% e studentëve meshkuj të Fakultetit të Mjekësisë ishin duhanpirës. Statistikat nga Dhoma e Tregtisë së Arabisë Saudite tregojnë një rritje të pabesueshme në importet e duhanit, mbi 4.5 milionë kg në 1972, mbi 27 milion kg në vitin 1977, gati 36 milionë kg në vitin 1981, 42 milionë kg në vitin 1984, një rritje prej 900%. Nuk është befasi të gjendet se kanceri i mushkërive në Arabinë Saudite është rritur në mënyrë dramatike, nga kanceri i 12-të në një studim në vitet 1950-61 në kancerin e tretë më të zakonshëm në një studim në vitet 1979-84. Ai pritet të jetë kanceri kryesor në vitet 90-të e më pas, sepse efektet e pirjes së

duhanit po zhvillohen më tej.

Metodat e kompanive të duhanit janë të paskrupullta, si dhe agresive, duke kompromentuar zyrtarët e qeverive për të lejuar promovimin e markave të tyre. Në vitin 1982, kreu i parlamentit të Malajzisë dha dorëheqjen dhe shkoi për të punuar si drejtor i kompanisë Rothmans, prodhuesi më i madh i cigareve në Malajzi. Etiopia importoi 200 milionë cigare të shtrenjta britanike në vitin 1984, kur një pjesë e madhe e shtetasve të saj ishin të uritur për vdekje. Në Bangladesh, pirja e pesë cigareve në ditë iu vjedh familjes 1/4 e të ardhurave të saj për ushqimet, e cila rezulton në rreth 18.000 vdekje të fëmijëve në vit. Për fat të keq, Banka Botërore dhe qeveritë perëndimore po bashkëpunojnë me shtatë kompanitë gjigante të duhanit (tre amerikane, tre britanike dhe një franceze). Banka Botërore i ka dhënë Pakistanit 60 milion dollarë kredi për të rritur duhanpirjen dhe ShBA kanë shpenzuar 2 miliardë dollarë hua për vendet në zhvillim për blerjen e duhanit dhe për të krijuar projekte të sipërmarrjes së përbashkët dhe fabrikave të duhanit.

OBSH thekson nevojën për një ndalim në promovimin e duhanit, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës, të zbatohet plotësisht, të publikohet dhe t'i jepet prioritet i madh nga qeveritë dhe autoritetet shëndetësore dhe të jetë i qëndrueshëm në një bazë afatgjatë.

Ligji islam dhe duhanpirja

Dijetarët më në zë të Islamit e kanë ndaluar pirjen e duhanit shumë shpejt pasi ai u prezantua në Turqi rreth vitit 1000 H (1573). Sulltan Murati i Kalifatit Osman e bëri atë një vepër të dënueshme kapitale në vitin 1663. Ish kryemyftiu i Arabisë Saudite, Shejh Muhammed bin Ibrahim kishte përfshirë në fetvanë e tij emrat e shumë ulemave të mëdhenj dhe myftinjve që kishin ndaluar pirjen e duhanit nga paraqitja e tij e parë në Turqi, Marok, Egjipt, Siri dhe Jemen. Të gjithë autoritetet fetare në Arabinë Saudite, duke përfshirë natyrisht edhe imamin e madh, Shejh Abdul Aziz bin Baz, e kanë ndaluar përdorimin e duhanit, promovimin e tij, shitjen, kultivimin dhe çdo gjë që ka të bëjë me të në ndonjë mënyrë tjetër.

Konferenca Islamike e Ulemave (për drogën, narkotikët dhe pijet me ngjyrë e mbajtur në Medinë, 22-25 mars 1982, nën kujdesin e princit Abdullah bin Abdul Aziz) miratoi një rezolutë që ndalon përdorimin e duhanit në çdo formë të tij, kultivimin, prodhimin, tregtimin, shitjen ose promovimin në mënyrë kategorike.

Zyra e OBSH për Mesdheun Lindor botoi një libër në vitin 1988 nën titullin Al-Hukm al-Sheriati fi at-Tadkhin (ligji islam për pirjen e duhanit), që përfshinte vendimin e dhjetë ulemave më të rëndësishëm të Egjiptit, duke përfshirë Shejhu'l-Az'har, i cili në mënyrë të qartë e konsideron përdorimin e duhanit si haram.

Arsyet për këto ligje ishin:

1. Pirja e duhanit është e dëmshme për shëndetin. Kur'ani thotë qartë: "Mos e vrisni veten tuaj" (4:29) dhe "mos e hidhni veten tuaj në shkatërrim" (2:195). Mësimet islame në përgjithësi, si dhe qindra thënie të Profetit, paqja qoftë mbi të, inkurajojnë myslimanët për të ruajtur shëndetin dhe të heqin dorë nga gjërat e dëmshme ndaj tij.

2. Duhanpirja i shpenzon njeriut shumën më të madhe parash. Arabia Saudite shpenzon çdo vit më shumë se një miliard rial në importe të duhanit. Disa vende të varfra myslimane shpenzojnë më shumë para për pirjen e duhanit se sa në promovimin e shëndetit apo arsimit. Kur'ani shprehet kështu mbi harxhimin e tepërt, "Mos e shpenzoni pasurinë tuaj kot. Shpërdoruesit janë me të vërtetë shokë të djallit" (17:26, 27).

3. Pirja e duhanit konsiderohet e papastër, khabeth. Kur'ani deklaron se Profeti, paqja qoftë mbi të, e këshillon popullin e tij "Ai ju ka ndaluar çdo gjë që është e keqe dhe e papastër dhe ka lejuar çdo gjë që është e mirë dhe e pastër" (7:157). Pirja e duhanit është e keqe dhe e papastër, pasi ajo shkakton ndotjen e mjedisit dhe është e pakëndshme, madje dhe seriozisht e dëmshme për ata që nuk pinë duhan. Të dëmtosh të tjerët është rreptësisht e ndaluar në Islam dhe konsiderohet si një nga mëkatet më të mëdha që një besimtar mund të kryejë.

Ekziston një nevojë e madhe për të informuar komunitetet myslimane në lidhje me opinionet ligjore për përdorimin e duhanit dhe arsyetimin për të. Qeveritë myslimane duhet të qëndrojnë të vendosura kundër presionit të ushtruar mbi to nga kompanitë e duhanit dhe mbështetësit e tyre të fuqishëm perëndimorë. Nëse vendet myslimane edhe popujt u përmbahen jetesës tradicionale fetare, ata do të kenë sukses në shmangien e rreziqeve dhe humbjeve tragjike të jetës e të pasurisë të shkaktuara nga konsumi i duhanit.

Përktheu: Erion Sukaj

Drita mahnitëse

Njeriu i parë që krijoi Allahu i Madh në tokë ishte Ademi. Profeti Adem a.s., sapo erdhi në jetë, ngriti kokën dhe pa një dritë shkëlqyese që e mahniti krejtësisht. Ky në fakt ishte një shkëlqim. Ky shkëlqim vinte prej një emri që qëndronte i shkruar në qiell. Profeti Adem, që po e vështronte i mahnitur dritën që kishte përpara syve, e pyeti Allahun:

- "O Zot! Çfarë është ky shkëlqim, ç'është shkruar aty?"

Allahu iu përgjigj:

- "Ky është shkëlqimi i një profeti që do të vijë prej gjakut tënd. Emri i tij në qiej është Ahmed, ndërsa në tokë Muhamed. Nëse nuk do të ishte ai, Unë nuk do të të krijoja ty."

Profeti Adem ishte njeriu i parë në tokë, njëkohësisht edhe babai i të gjithë njerëzve që erdhën më pas. Allahu i Madh i krijoi Babait tonë si bashkëshorte Havanë, dhe iu drejtua me këto fjalë:

- "Hani, pini dhe shëtisni si të dëshironi në Xhenetin tim, por mos e prekni me dorë këtë frut sepse është i ndaluar për ju."

Një ditë, Havaja e nderuar e harroi se nuk duhet të hante prej frutit të ndaluar dhe i ofroi edhe Profetit Adem që të hante prej këtij fruti. Ndërkohë që edhe Profeti Adem e harroi se nuk duhet të hante prej frutit të ndaluar. Ata hëngrën të dy prej frutit sepse harruan, prandaj Allahu i largoi prej Xhenetit në tokë që të shlyejnë gabimin që ata kishin bërë. Mirëpo, Ai i vendosi ata në vende të ndryshme të botës.

Pjesë nga divani i Imam Shafiut Gazel

Kujesë

Behu i devotshem ndaj Zotit, në qoftë se je hutuar!
Te mirat t'i sjell nga diçka e pamenduar.
Pse vallë ke frikë varfërinë? Zoti furnizon,
ka ushqyer zogun dhe peshkun kur noton.
Dhe kush kujton, se të mirat vijnë me egërsi,
S'do kish' ngrënë gjë pellumbi, me skifterin në liri!
Zemërmirë në këtë botë bëhu, se ti nuk edi,
a jeton nga mbrëmja deri sa të dalë dielli.
Sa te shëndoshë kanë shkuar, pa bere 'uf'e 'i
dhe sa të semurë jetuan ditët në vetmi?
Sa të rinj kanë fjetur, duke qeshur janë zgjuar
pa e ditur, se pas qeshjes Zoti vdekjen u ka dërguar...
Mos harro, se në këtë botë s'je veçse udhëtar
dhe nesër do të kthehesh të gjyshërit me baballarë!

I dashuruari i bindet atij që dashuron
S'i bindesh Allahut dhe pretendon dashurinë e Tij,
Kjo është e pamundur, me logjikë e refuzuar.
Nëse dashuria jote do ishte e singertë, do i bindeshe Atij,
I dashuruari i bindet atij që dashuron.

Kështu e ka jeta
Nëpër pyje, nga uria, vdesin luanët,
kur mishin e bagëtive e hanë qentë.
Dhe skllavi, ndoshta mbi mendafsh fle,
ndërsa të pasurit i mbulon një dhe...



Dhuro

ZEKATIN, SADAKANË E FITRIT, FIDJEN

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është organi zyrtar i përfaqësimit të myslimanëve në Shqipëri, dhe si i tillë, mbledh dhe shpërndan me përgjegjësi të plotë amanetin e besimtarëve dhe çdo qytetari.



- ✓ NISABI 750.000 lekë
- ✓ SADAKAJA E FITRIT 400 lekë

PayPal: @albaniakmsh
Banka Kombëtare Tregtare
NR. 110000709 | SWIFT: NCBAALTXXX

IBAN ALL: AL 14 2051 1014 0007 09CL TJCL ALLO
IBAN USD: AL 85 2051 1014 0007 09CL TJCF USDA
IBAN EUR: AL 41 2051 1014 0007 09CL TJCF EURA